



1. KUPTIMI I ZHVILLIMIT TË FËMIJËS

HYRJE

Gjatë kujdesit për fëmijët dhe punës me to, është me rëndësi të kuptohet zhvillimi i tyre. Është e pamundur të mendohet për përmbushjen e nevojave të fëmijëve nëse nuk e dini se çka pritet prej fëmijëve, fjala bie, në raport me të menduarit, komunikimin dhe aftësitë fizike. Ju do t'i studioni principet e zhvillimit dhe pesë fazat kryesore që nga lindja e deri në moshën 16-vjeçare, para se të filloni të mendoni se si zhvillohen shkathtësitë fizike, sociale, emocionale dhe intelektuale.

Në këtë dokument ju:

1. do ta kuptoni rritjen dhe zhvillimin fëmijëve
2. do ta kuptoni rolin e vëzhgimit në zhvillimin e fëmijëve në vendin e punës
3. do të mësoheni ta vëzhgoni zhvillimin e fëmijëve
4. do ta kuptoni se pse është i nevojshëm planifikimi që ashtu të përkraken nevojat dhe zhvillimi i fëmijëve.

1.1. KUJDESI I PARË PËR FËMIJËT, MËSIMI DHE ZHVILLIMI

Kjo pjesë i mbulon këto çështje:

- principet e zhvillimit
- fazat dhe rendi i zhvillimit
- zhvillimi fizik
- zhvillimi emocional
- zhvillimi social
- zhvillimi i komunikimit dhe të folurit
- zhvillimi intelektual
- pjekuria
- faktorët që ndikojnë ndaj rritjes dhe zhvillimit

RITJA DHE ZHVILLIMI

Çka nënkuptojmë me rritjen dhe zhvillimin? **Rritja** nënkupton zmadhimin e dimensioneve të trupit – për nga gjatësia, pesha dhe sferat e tjera që mund të maten. **Zhvillimi** është përvetësim i shkathtësive në të gjitha aspektet e jetës së fëmijës. Llojet e ndryshme të zhvillimit shpeshherë janë të ndarë në katër fusha:

Zhvillimi fizik - kjo ka të bëjë me shkathtësitë dhe mundësitë e trupit dhe përfshin:

- zhvillimin e motorikës së përgjithshme (shfrytëzimi i muskujve të mëdhenj), siç janë këmbët dhe duart;
- zhvillimin e motorikës së lehtë (përdorimi preciz i muskujve), siç janë pëllëmbët dhe gishtat

Zhvillimi social dhe emocional – është zhvillim i identitetit dhe ndjenjave për vetveten dhe mësimi i shkathtësive për të jetuar në shoqëri me njerëz të tjerë.

Zhvillimi intelektual – është mësim i shkathtësive të të kuptuarit, mbamendjes dhe përqendrimit

Zhvillimi i komunikimit dhe të folurit – është mësim se si të komunikohet me miqtë, familjen dhe të gjithë të tjerët.

Megjithatë është me rëndësi të kuptohet se të gjitha fushat e zhvillimit janë të lidhura mes vete. Vetëm ndaluni dhe mendoni për ndryshimet që zhvillohen te fëmija në zhvillim.

Me lindjen e njeriut në fakt ndodhë një ndryshim i jashtëzakonshëm nga dy qeliza të vogla, siç janë qeliza vezë dhe spermatozoidi, të cilat bashkohen gjatë fekondimit të tyre, deri në një organizëm të ndërlikuar, siç është bebja pas lindjes. Pastaj, nga një qenie e pandihmë gjatë lindjes deri në moshën 16-vjeçare fëmija ndryshon në një personalitet të ri kompleks, i cili i ka të gjitha shkathtësitë e nevojshme themelore për jetë, duke përfshirë të folurit, vrapimin, shkrimin dhe aftësinë që të mendohet në mënyrë abstrakte.

- Peshë rritet nga 3 deri në 4 kg, që është gjatë lindjes, deri në peshën mesatare prej 65 kg të një djali të ri.
- Gjatësia, që gjatë lindjes është rreth 35 cm, ndryshon në më shumë se 155 cm.
- Nga një bebe relativisht e palëvizshme, fëmija mund të ecë, të kërcëjë dhe të ngjitet diku.
- Nga pamundësia për të folur, fëmija përvetëson aftësi për të komunikuar.
- Nga një bebe plotësisht e varur, fëmija mësohet që vetë të vishet, të ushqehet dhe të mendojë.
- Nga lëvizjet me hapje të duarve dhe kapje automatike të gjithë asaj që i jepet në dorë, fëmija mësohet se si ta kapë dhe përdorë lapsin, e pastaj zhvillohet që të mund të mbajë dhe përdorë stilolaps, kompjuterë dhe pajisje tjetër teknike.

Rritja dhe zhvillimi janë të lidhura, por dallohen shumë mes vete. Rritja është zmadhim shumë i dukshëm i madhësisë së fëmijës. Ajo mund vërehet në mënyra të ndryshme, duke përfshirë edhe rritjen e peshës, rritjen e gjatësisë dhe rritjen e vëllimit të kokës. Fëmijët rriten shumë shpejt; pyetni prindërit tuaj se a i kanë regjistruar rritjet e peshës dhe të gjatësisë suaj.

PRINCIPET E ZHVILLIMIT

Ekzistojnë tre principet themelore të zhvillimit të njeriut, që janë të ndryshueshme për të gjithë pas lindjes.

1. Zhvillimi fillon nga koka dhe zhvillohet teposhtë nëpër trup

Fëmija i porsalindur nuk mund ta mbajë kokën e vet drejt. Megjithatë, për vetëm disa muaj, bebja do të mund të ulet. Kjo është rezultat i asaj që kontrolli i boshtit kurrizor dhe sistemi qendror nervor zhvillohet nga maja e kokës teposhtë deri në bazën e boshtit kurrizor. Ky kontroll mund të vërehet te fëmija, ashtu siç fillon ai ta mbajë kokën në mënyrë të pavarur. Ngjashëm me këtë, bebja e porsalindur luhetet andej-këndej me duart e veta, ndërsa për nëntë muaj ai arrin ta gjejë edhe thërmijën ose pjesëzën më të vogël dhe të kapë gjëra me gishtin e tij tregues dhe gishtin e madh. Kjo është rezultat i asaj se sistemi nervor po ashtu zhvillohet nga boshti kurrizor drejt ekstremiteteve (këmbëve dhe duarve).

2. Zhvillimi rrjedh sipas rendit të njëjtë, por mund të ndodhë me shpejtësi të ndryshme

Bebja duhet ta mbajë kokën drejt, të mësohet të ulet duke u mbajtur, e pastaj edhe pa i ndihmuar fare, para se të mësohet të qëndrojë në këmbë duke u mbajtur për mobilie, ndërsa me kalimin e kohës edhe të ecë në mënyrë të pavarur. Asnjë bebe nuk mund të mësohet të ecë para se të mësohet të drejtohet. Por, është krejt normale që një bebe të ecë në nëntë muaj, ndërsa një bebe tjetër të mos e mësojë këtë shkathtësi deri në moshën 18-muajshe.

3. Të gjitha fushat e zhvillimit janë të lidhura mes vete

Bebja nuk mund të fillojë të ushqehet me gishta derisa nuk do të mund ta drejtojë dhe zhvillojë shkathtësinë e kapjes së sendeve me gishtin e madh dhe gishtat e tjerë. Zhvillimi i të folurit te fëmija varet nga ajo se nëse ka fëmijë vështirësi të dëgjojë qartë ose nëse askush nuk i flet drejtpërdrejt atij.

Fëmija që nuk pranon dashuri dhe kujdes, nuk arrin të rritet dhe të zhvillohet..

Në fund, mbani mend se që të zhvillohen deri në potencialin tij të plotë, fëmijët kanë nevojë për mbështetje të madhe dhe udhëheqje prej njerëzve të tjerë në jetët e tyre. Mossuksesi i përmbushjes së të gjitha nevojave të bebes mund të ketë pasoja serioze ndaj zhvillimit të tij.

KTHESAT

Ekspertët e zhvillimit të fëmijëve kanë realizuar shumë hulumtime me fëmijët e vegjël që ashtu të zgjidhin atë që shumica e fëmijëve mund ta bëjnë në moshë të ndryshme dhe me shpejtësinë me të cilën rriten. Nga ky hulumtim janë identifikuar kthesat në zhvillim. E a.q “kthesa në zhvillim” ka të bëjë me rritjen, në të cilën shumica e fëmijëve do të duhej të arrinin deri në një fazë të caktuar, për shembull, ecja në mënyrë të pavarur deri në 18 muaj ose buzëqeshja deri në 6 javë.

Në moshën e tyre 6-javëshe shumica e bebeve do të buzëqeshin jo sepse kanë gazra ose se ushtrojnë muskujt, por sepse dikush u flet dhe u qeshet, prindërit ose kujdestarët e tyre. Për fat të keq, jo të gjitha bebet kanë kujdestarë që brengosen për ato, të cilët për arsye të ndryshme nuk u buzëqeshin ose nuk u flasin. Këto bebe ndoshta nuk do të buzëqeshin pas 6 javëve. Bebja që ka shijuar shumë të folur dhe komunikim, mund të buzëqeshë shumë më herët se gjashtë javët dhe do të vokalizojë me atë që kujdeset për atë.

Shumë fëmijë e arrijnë atë fazë të zhvillimit edhe shumë më herët, por me rëndësi është se a e ka arritur fëmija fazën e zhvillimit të moshës, e cila është “kthesë në zhvillim”. Do të lexoni edhe për rritjen mesatare në fazat zhvillimore, ndërsa ato do të jenë të ndryshme. Rritja mesatare është në mesin e moshës, kur të gjithë fëmijët do të arrijnë një fazë të caktuar, si fjala bie, për ecjen moshë mund të jetë nga

10 deri në 18 muaj dhe, sipas asaj, moshë “mesatare” e ecjes është 14 muaj. Është me rëndësi të mbahet mend se të gjithë fëmijët zhvillohen me shpejtësi të ndryshme, andaj disa aspekte të zhvillimit mund të arrihen më herët, e disa më vonë.

PËRQINDJET

Grafikonë me përqindje përdoren që të krahasohet rritja e fëmijëve dhe matja e peshës së fëmijëve të tjerë të grupit të të njëjtë të moshës. Kjo mundëson të ndiqet rritja e fëmijëve gjatë viteve dhe të vëzhgohet se si rritet fëmija në raport me fëmijët e tjerë. Grafikonët mund të përdoren për t’u njohur se a ka ndonjë problem me gjatësinë ose peshën e fëmijës, veçmas nëse shkalla e pritshmërisë nuk realizohet. Skica e këtyre rritjes së fëmijës është pjesë standarde e secilës këshillimore për kontrollime sistematike të bebeve dhe fëmijëve të vegjël, ku matet pesha dhe gjatësia e bebes ose fëmijës.

Pyetni prindërit se a e kanë librin në të cilin është regjistruar pesha juaj kur keni qenë bebe që ta shihni se ku keni qenë në grafikon. Ose, pyeteni ndonjë farefis që ka fëmijë të vogël që t’i verifikoni të dhënat e tij për peshën.

Ekzistojnë grafikonë të ndryshëm për djem dhe për vajza, sepse ekziston dallim në shkallët e tyre të zhvillimit dhe të rritjes, si dhe grafikonë të ndryshëm për bebet që lindin para kohe. Grafikonët e shprehin diapazonin normal të gjatësisë dhe peshës për moshën përkatëse të mijëra fëmijëve të pjesëve të ndryshme të vendit.

FAZAT DHE RENDI I ZHVILLIMIT

Për rritjen dhe zhvillimin mendojmë në pesë faza:

- fëmijëria e hershme që nga lindja deri në vitin e parë të jetës
- fëmijëria e hershme nga një deri në tre vite
- fëmijëria nga katër deri në shtatë vite

- puberteti nga tetë deri në dymbëdhjetë vite
- adoleshenca nga trembëdhjetë deri në gjash-tëmbëdhjetë vite.

Lindja deri në një vit

Fëmijët e vegjël mund:

- t'i shikojnë personat si forma të paqarta
- të kapin një send që e ka prekur pëllëmbën e dorës së tyre
- ta kthejnë kokën dhe ta kërkojnë kokrrën ose gjirin, nëse preken me të në faqe
- të thithin dhe të gëlltisnin
- të përpiqen të bëjnë lëvizje për të ecur me hapa, nëse mbahen drejt, me këmbë mbi një bazë të fortë
- të frikësohen si reagim ndaj një tingulli të papritur ose ndaj një drite të fuqishme
- papritmas t'i shtrojnë duart, e pastaj t'i mbledhin rreth vetes nëse kanë ndjenjë se janë duke u rrëzuar.
- ta dallojnë zërin dhe erën e nënës së tyre të qajnë kur janë të uritur, kur u dhemb diçka, kur kanë nevojë për ushqim, kur duhet t'u ndërrohen pelenat ose kur kanë nevojë vetëm të përqafohen.

Një deri në tre vite

Deri në ditëlindjen e tyre të parë bebet mund:

- të lëvizin përreth duke u zvarritur ose duke u tërhequr, disa mund të qëndrojnë në këmbë me pak ndihmë, ndërsa një numër i vogël i tyre mund të ecin në mënyrë të pavarur
- vetë të drejtohen dhe të ushqehen, së paku me gishtat e tyre
- t'i përdorin me shkathtësi duart që t'i lëvizin dhe t'i radhisin sendet, duke përfshirë edhe lëshimin e sendeve në dysHEME dhe vëzhgimin mbi to që të shohin se ku gjenden
- të bëjnë me dorë për "çao" dhe të bëjnë me shenjë me gisht kah sendet
- të komunikojnë duke mermëritur dhe duke shqiptuar fjalë me dy rrokje si "dada"
- ta kuptojnë botën përreth tyre
- ta dinë se kush janë kujdestarët e tyre krye-

sorë dhe të qajnë nëse lihen me dikë që nuk e njohin.

Ditëlindja e tretë

Deri në ditëlindjen e tyre të tretë fëmijët mund:

- të vrapojnë, të ngjiten dhe të ngasin triçikël
- të lëvizin nëpër shkallë, duke i ndërruar këmbët njëra pas tjetrës dhe të ecin në gishta
- ta kryejnë vetë nevojën e tyre fiziologjike
- të flasin qartë që t'i kuptojnë të gjithë
- të bëjnë dallim ndërmjet djemve dhe vajzave
- ndonjëherë të luajnë bashkë me fëmijët e tjerë
- të bëjnë kullë nga nëntë katrorë dhe të bëjnë urë me katrorë
- t'i ngjisin pullat dhe të bëjnë varg me rruaza
- të kënaqen në luajtjen e roleve me lodra dhe me rregullimi e tyre perfekt
- të kënaqen me libra
- të kënaqen duke vizatuar dhe "të shtiren" se shkruajnë
- të kenë më pak shfryrje të hidhërimit (të cilin kanë filluar ta kenë që nga mosha 18-muajshe)
- të kënaqen në kopjimin dhe ndihmën e të rriturve.

Ditëlindja e shtatë

Deri në ditëlindjen e tyre të shtatë fëmijët mund:

- ta gjuajnë, të godasin dhe ta kontrollojnë topin, të kërcejnë dhe të ngasin biçikletë
- t'i përdorin duart e tyre që ta fusin perin në gjilpërë, të përdorin gërshtë, të krijojnë modele dhe të shkruajnë qartë
- të vizatojnë me kuptim dhe me detaje
- të ndërrohen dhe të luajnë së bashku me shokët
- të tregojnë mahi dhe të kënaqen me bisadat e tyre
- të fillojnë t'i kuptojnë rregullat
- të frikësohen nga gjërat e imagjinuara, si lugetërit

- të lexojnë dhe të kënaqen me libra
- të vishen vetë dhe këtë ta bëjnë lehtë
- të kenë shokun më të mirë
- të brengosen nëse nuk i pëlqejnë dikujt.

Ditëlindja e dymbëdhjetë

Deri në ditëlindjen e tyre të dymbëdhjetë fëmijët mund:

- të zgjidhin probleme
- të kënaqen me përgjegjësin e tyre
- të kenë interes të madh për hobi
- të përdorin shkathtësi të mira për koordinim
- t'ju tregojnë se për çka janë të aftë
- të fillojnë t'i vërejnë ndryshimet fizike në trupin e tyre
- të fillojnë të zihen me prindërit e tyre
- ndonjëherë të sillen si të rritur, e ndonjëherë si fëmijë.

Ditëlindja e gjashtëmbëdhjetë

Deri në ditëlindjen e tyre të gjashtëmbëdhjetë fëmijët mund:

- ta kenë trupin e një të rrituri
- të kenë shkathtësi të shkëlqyeshme për fus-ha të caktuara, si për shembull, për të vizatuar ose për të punuar në kompjuter

- të kënaqen në shoqërinë “e shokëve” më shumë se kur janë me familjen e tyre
- të krijojnë identitetin e tyre, shijen për muzikë e për veshje
- të kenë ndryshime të mëdha në disponim
- ndonjëherë të ndjehen të shqetësuar

ZHVILLIMI FIZIK

Zhvillimi fizik i mbulon aspektet e zhvillimit për të cilat mund të shohim se si ndodhin. Për shembull, farefisi shpesh komentojnë se sa është rritur fëmija. Ata komentojnë se sa është rritur në aspekt të madhësisë, gjatësisë dhe peshës. Me rritjen e tij ndodhin edhe ndryshime të konsiderueshme në proporcionet e trupit. Shikojeni madhësinë e kokës së fëmijës së porsalindur në raport me pjesën tjetër të trupit. Krahasojeni me një fëmijë të moshës shtatë deri në tetë vjeç.

Zhvillimi fizik po ashtu i mbulon shkathtësitë e rëndësishme për shfrytëzimin e trupit tonë; përdorimi i muskujve të mëdhenj për të ecur, për të vrapuar, për t'u ngjitur, për të kërcyer dhe për t'u hedhur, si dhe përdorimi i muskujve tanë më të vegjël, për shembull, për koordinimin e duarve. Shikojeni tabelën që ta krahasoni motorikën e përgjithshme në fazat e ndryshme të zhvillimit.

MOSHA	ZHVILLIMI FIZIK (MOTORIKA E PËRGJITHSHME DHE E LEHTË)
Lindja deri në 4 javë	Rri shtrirë në shpinë, ndërsa kokën e mban të kthyer në njërin anë Koka tërhiqet kur e ngrenë që të ulet Reflekse primitive, përkatësisht kërkimi i gjirit, thithja, eca, kapja
1 muaj	Kontrolli i kokës ende është jostabil Duart i ka të shtrënguara fort në grushte I kap sendet që e prekin pëllëmbën e dorës së tij Koka dhe sytë lëvizin bashkë
3muaj	Shqelmon me këmbë dhe luan me duar Mund ta ngrëjë kokën dhe të rrotullohet kur është i shtrirë në anën e përparme I sheh lëvizjet e duarve të tij, luan me duar E mban trokitësen disa sekonda nëse ajo i vihet në dorë
4muaj	I përdor duart si mbështetje për t'u mbajtur kur rri i shtrirë në bark Kthehet anash duke qëndruar në shpinë Mbahet dhe i luhat sendet e vogla
6muaj	Ulet me ndihmë Rrotullohet Kur rri shtrirë në bark, e ngre me duar kokën, qafën dhe kraharorin nga dyshemeja E përdor gjithë dorën që të kapë, e hedh lodrën nga njëra dorë në tjetrën
9muaj	Ulet vetë, pa ndihmë. Dëshiron t'i marrë lodra kur rri ulur Mund të zvarritet ose të tërhiqet I shpon sendet e vogla me gishtin tregues E përdor gishtin tregues dhe gishtin e mesëm me gishtin e madh që të kapë sende të vogla Në secilën dorë dëshiron të marrë dhe të mbajë katrorë të vogël I ngre katrorët, por mund t'i vendosë diku vetëm duke i lëshuar
1 година	Rri në këmbë vetë dhe, duke u mbajtur, fillon të ecë. Është i lëvizshëm përmes zvarritjen dhe tërheqjes. Dëshiron të ushqehet vetë dhe ta mbajë filxhanin me ndihmën e dikujt I ngre gjërat e imëta nga dyshemeja, duke përdorur kapje precize si me dara Fillon të shfaq prirje për përdorimin e dorës së majtë ose të djathtë. I bashkon dy katrorë I vendos katrorët në kuti pasi që t'i tregohet kjo procedurë
18muaj	Mund të ecë vetë I shtyn dhe i tërheq lodrat derisa ecë Mund të ecë teposhtë kur e mbajnë për dore Përpiqet ta goditë, të pasojë dhe ta hedhë topin Përkulet të ngrëjë sende nga dyshemeja Ndhmon gjatë veshjes dhe zhveshjes së tij Mund të përdorë lugë Përdor shtypje precize për sende të imëta Mban në dorë ngjyrë në mënyrë të thjeshtë, me tre gishta dhe shkarravit I hap lodrat I zbath këpucët

MOSHA	ZHVILLIMI FIZIK (MOTORIKA E PËRGJITHSHME DHE E LEHTË)
2 vjeç	<p>Ecë përpjetë nëpër shkallë, me dy këmbë në një shkallë</p> <p>Ngjitet në mobilie</p> <p>Ndërton kullë me gjashtë katrorë</p> <p>Ushqehet vetë me lugë Mbath këpucë</p> <p>Vizaton rrathë dhe pika</p> <p>Почнува да ја користи преферираната рака</p>
3 vjeç	<p>Qëndron në gishta dhe ashtu mund të ecë</p> <p>E godet topin i sigurt</p> <p>Kërcen nga shkallët e poshtme</p> <p>Vozit triçikël</p> <p>I shfleton faqet e librit</p> <p>Mund të vizatojë fytyrë</p> <p>Bën ura me katrorë, kur i tregohet kjo</p> <p>Thur pulla</p> <p>Krijon vargje të mëdha me rruaza</p>
4 vjeç	<p>Mund ta gjuajë topin e madh në shenjë, ta hedhë dhe ta kapë</p> <p>Ecë së prapthi dhe nëpër vijën e përcaktuar</p> <p>Vrapon dhe kërcen Bën kullë të madhe</p> <p>I lan vetë dhëmbët</p> <p>Pret formë rrethore me gërshërë dhe vizaton katror</p> <p>E thur dhe shtur veshjen</p> <p>Mund ta kompletojë lojën për harmonizim të përbërë prej 12 pjesëve</p>
5 vjeç	<p>Kërcen</p> <p>Vrapon shpejt</p> <p>Vishet dhe zhvishet lehtë</p> <p>E godet topin me levë</p> <p>Vizaton njeri me kokë, trup dhe këmbë, si dhe shtëpi</p> <p>Mund ta kompletojë lojën për harmonizimin të përbërë prej 20 pjesëve</p> <p>Formon shkronja dhe e shkruan emrin e tij</p> <p>I përdorë gërshërët në mënyrë precize</p>
6–7 vjeç	<p>Kënaqet duke kërcyer, duke vozitur biçikletë, rolerka dhe duke rrëshqitur</p> <p>Kënaqet në mbajtjen e baraspeshës në mur ose në tra</p> <p>Manipulon më mirë me dorë gjatë ndërtimit të katrorëve, lojës për harmonizim etj.</p> <p>Mund të qepë tegel</p> <p>Lidh/zgjidh lidhëse</p> <p>Krijon modele të ndërlikuara</p> <p>Shkruan me laps në sipërfaqe të vogël dhe vizaton vizatime të detajuara</p>
8–12 vjeç	<p>I përmirëson shkathtësitë fizike që tashmë janë zhvilluar</p> <p>Puberteti te vajzat fillon rreth moshës 10 vjeç, me rritje të shpejtë dhe përforsim të fuqisë së trupit</p>
13–16 vjeç	<p>Truri rritet gjatë kohës për reagim dhe koordinim</p> <p>Te vajzat puberteti përfundon në moshën rreth 14 vjeç dhe atëherë fillojnë menstruacionet</p> <p>Te djemtë puberteti është në moshën 13-16 vjeç, por ata do të jenë më të fuqishëm se vajzat</p>

ZHVILLIMI SOCIAL DHE EMOCIONAL

Të mësuarit e jetës me njerëz të tjerë, si në familjen tonë, ashtu edhe në shoqëri, më shpesh është një nga pjesët më të rëndësishme të zhvillimit – një pjesë në të cilën familja dhe miqtë luajnë rol të rëndësishëm.

Socializimi është mësim se si të sillemi me familjen dhe shoqërinë në të cilën jetojmë. Procesi i socializimit, për nga përkufizimi i tij, do të dallohet në shoqëri të ndryshme dhe nga familja në familje.

- Socializimi primar është socializim që zhvillohet në kuadër të familjes, në vitet e para të jetës së fëmijës. Kjo u ndihmon fëmijëve të mësohen të komunikojnë me të tjerët, çka është e pranueshme e çka nuk është.
- Socializimi sekondar fillon kur fëmijët vendosin kontakt të drejtpërdrejtë me njerëzit dhe me mjedisin jashtë shtëpisë së tyre. Këtu bie: çerdhja, foshnjorja dhe shkolla, ndërsa vazhdon gjithë jetën.

Socializimi sekondar i mëson fëmijët:

- si të komunikojnë me të rriturit që nuk janë të familjes së tij
- si të komunikojnë me miqtë dhe personat e tjerë
- me „rregullat“ e shoqërisë, çka është e pranueshme e çka nuk është e pranueshme jashtë shtëpisë.

Një numër i caktuar i proceseve themelore ndikojnë në ndërlidhjen tonë të mirë me të tjerët dhe përshtatjen me familjen tonë dhe me botën shoqërore. Para se t'i shqyrtojmë fazat e zhvillimit social dhe emocional, duhet të mendojmë se sa janë të rëndësishme që nga fillimi afrimi dhe ndërlidhja, njohja e vetvetes, identiteti personal dhe besimi.

Afrimi dhe ndërlidhja

Zhvillimi i ndjenjave të fuqishme ndërmjet prindërve ose kujdestarëve dhe fëmijëve të tyre ndodhë përmes procesit të afrimit dhe ndërlidhjes. Kjo ndërlidhje në muajt e parë është e ndihmuar nga disa gjëra, duke përfshirë edhe:

- kontaktin përmes lëkurës
- aromën
- të folurit dhe të dëgjuarit e zërave të prindërve
- të ushqyerit
- larjen
- lojën
- kontaktin përmes shikimit në sy.

Ndërlidhjet e shumta

Zhon Boulbi, i njohur për përshkrimet e tij të afrive dhe ndërlidhjeve, e konfirmoi idenë se të gjithë fëmijët kanë nevojë për kujdestarë të vazhdueshëm që ashtu t'u lejohej ta zhvillojnë ndërlidhjen dhe të fillojnë të krijojnë lidhje plor dashuri me kujdestarët e tyre.

Afria është zhvillim i ndjenjave të fuqishme ndërmjet prindërve dhe kujdestarëve, si dhe fëmijëve të tyre. Afria e suksesshme është mënyrë se si bebjat të jetë e sigurt nga keqpërdorimi dhe braktisja.

Ndërlidhja është lidhje e ngushtë emocionale ndërmjet bebes dhe kujdestarit të tij.

Nëse periudha pas lindjes është e ndërprerë me sëmundjen e nënës ose të bebes ose po që karakterizohet me kujdestarë të shumtë e të ndryshëm, fëmija mund të ketë vështirësi në formimin e lidhjeve të afërsisë më vonë në jetë.

Përpiquuni t'ia fshihni lodrën nën jastëk fëmijës 12-muajsh. Nëse ju sheh se si ia fshihni lodrën, ai do ta gjejë. Nëse nuk ju sheh, nuk do ta gjejë. Ashtu siç rritet, fëmija mësohet ta kërkojë lodrën në shumë vende të vështira.

Deri tash është menduar se bebjat mund të formojnë ndërlidhje të afërt vetëm me nënën, por është dëshmuar se kjo nuk është e vërtetë. Fëmijët mund të formojnë lidhje të fuqishme me njerëz të shumtë e të ndryshëm, madje këtë e bëjnë edhe me, bie fjala, gjyshërit dhe gjyshet, prindërit, vëllezërit dhe motrat, miqtë etj. Kontakti i rregullt dhe i shpeshtë është i rëndësishëm, madje edhe kur fëmija ka ndërlidhje normale për prindërit dhe familjen. Me rëndësi është që bebes ose fëmijës së

Hulumtimet e viteve të '50-ta e kanë identifikuar problemin e paraqitjes së shqetësimit për shkak të ndarjes. Ky hulumtim i fëmijëve që janë të ndarë na prindërit e tyre në spital ishte i rëndësishëm që të krijohet shprehia e inkurajimit të prindërve që të mbeten me fëmijët e tyre në spital. Por, deri në vitet e '70-ta kjo nuk ishte e lejuar, sepse mendohej se vizitorët do t'i shqetësojnë fëmijët.

vogël në foshnjore t'i mundësohet të zhvillojë ndërlidhje me një kujdestar të vazhdueshëm.

Fëmija që ka krijuar lidhje të ngushta me disa njerëz të rëndësishëm ndjehet shumë më i sigurt se kur nuk e ka bërë këtë. Në rastet kur fëmija ndjen siguri të madhe, ka pak mundësi për paraqitjen e traumës emocionale të shkaktuar nga ndarja prej kujdestarëve kryesorë, që do të ndodhë në periudhën vijuese. Shpeshherë, në vitet e para të jetës, fëmija që është i lidhur shumë, ka vështirësi në formimin e lidhjes së ngushtë me kujdestarët.

Megjithatë, ndërlidhja e madhe nënkupton se, kur kujdestari i tij kryesor nuk është afër

atij, bebja ose fëmija do të shfaqë "shqetësim për shkak të ndarjes", duke e shprehur këtë përmes qarjes, bërtitjes dhe, nëse fëmija është më i madh, përmes përpjekjes që t'i vihet pas kujdestarit. Shqetësimi për shkak të ndarjes do të fillojë në moshën 6-7-muajshe dhe do të vazhdojë deri në moshën trevjeçare kur fëmija mund ta kuptojë se "nëna do të kthehet". Një pjesë e kësaj është edhe zhvillimi i konceptit të a.q. "vazhdimësia e sendeve", përkatësisht se, ndonëse diçka nuk mund të shihni, ajo megjithatë ekziston.

Самоосознавање и личен идентитет

Самоосознавањето и личниот идентитет на детето се тесно поврзани со квалитетот на воспитувањето во нивното рано детство. Многу млади луѓе и возрасни лица кои ги повредуваат другите или извршуваат тешки кривични дела имале многу негативни искуства како деца, а често пати нивното самоосознавање е на ниско ниво.

Многу психолози имаат проучувано како се развивае социјално и емоционално. Некои од клучните теории се опишани во долната табела.

Frojdi

Frojdi i ka identifikuar tre pjesë të personalitetit, duke filluar me lidhjen e "simbiozës" ndërmjet nënës dhe fëmijës në muajt e parë. Në këtë periudhë fëmija i vogël e sheh veten e tij si pjesë të nënës së tij. Ky është njëri ndër shkaqet që fëmija 8-muajsh bëhet "egocentrik" ose i vetëdijshëm për veten si i veçantë, i aftë të thotë "jo" dhe të ketë kontroll. Ashtu siç kalojmë nga fëmijëria në pjekuri, ne zhvillojmë qëndrime morale dhe "id"-i (Tash e dua) fillon të shtypet nga "superego"-ja (Jo, ajo është gabim). Ashtu siç zhvillohet "ego"-ja, ajo ndihmon që të ballafaqohemi me argumentet e brendshme që kështu të krijohet rezultat i pranueshëm.

Skiner

Skiner besonte se fëmijët mësojnë përmes përvojës ose kushtëzimit. Fëmija do të mësojë nëse shpërblehet për sjelljen e tij, madje edhe sikur "shpërblimi" të jetë i pakëndshëm. Shpërblimet ose pohimet pozitive për sjelljen e mirë janë baza e shumë programeve për udhëheqjen e sjelljes.

Bandura

Bandura e ka zhvilluar idenë për "modelimin" ose të mësuarit social. Në esencë fëmijët i kopjojnë të rriturit përreth vetes. Shihni se si fëmija i vogël e kopjon nxjerrjen e gjuhës nëse atë e bën edhe njeriu i rritur. Bandura e kupton zhvillimin e agresionit si rezultat të të mësuarit social. Eksperimenti i tij me fëmijët që shikojnë film, në të cilin të rriturit i godasin kukullat, ishte mahnitës, sepse fëmijët e kopjonin dhe e shihnin atë si sjellje të pranueshme. Ekzistojnë dëshmi të shumta se fëmija që ka qenë dëshmitar i dhunës ose që vetë e ka shijuar atë, në shtëpi mund të zhvillojnë prirje të dhunshme.

Teoria biologjike

Teoria tjetër për agresionin është ajo biologjike. Ajo thekson se njerëzit kanë nevojë për hapësirë ose territor dhe, nëse ajo hapësirë është e kërcënuar, atëherë ata do të reagojnë me agresion. Konsiderohet se edhe frustracioni nxit agresion; vëzhgojeni fëmijën e vogël që mund të bëjë diçka që dëshiron ta bëjë – rezultati mund të jetë shfryrje e tërbimit ose zbrazje e agresionit.

1. Shkruani dhjetë përgjigje të pyetjes “Kush jam unë?”. (Mendoni për paraqitjen tuaj, për shkathtësitë, karakterin, problemet dhe rolet tuaja në jetë.)

2. Përpiquni të identifikoni se kush ose çka është më e rëndësishme gjatë formimit të atyre ideve për vete.

Морален развој

Важен дел од социјалниот развој е моралниот развој. Децата го набљудуваат однесувањето на другите деца и возрасните, постепено развивајќи чувство на исправно и погрешно. „Приврзувањето“ е важно во моралниот развој каде што одредено однесување се поткрепува како исправно или погрешно – агесијата е добар пример за ова.

Просоцијално однесување

Напредна фаза од моралниот развој на детето е кога тоа е способно за просоцијално однесување. Ова се однесува на дело кое е од помош или од корист на останатите, но може да има некаква санкција за лицето кое го извршило. Екстреман пример на просоцијално однесување е некој човек да спаси друг човек од куќа што гори и да добие изгореници како резултат на тоа дело. Пovoобичаен пример може да биде кога детето го дава својот џепарлак за добротворни цели, наместо да ја купи играчката за која штедело. Можете ли да смислите други секојдневни примери?

MOSHA	ZHVILLIMI SOCIAL DHE EMOCIONAL
Lindja deri në katër javë	Reagon pozitivisht ndaj kujdestarit kryesor I imiton shprehjet e fytyrës I ngul sytë në sende të ndritshme shkëlqyese
1 muaj	Ua ngul sytë kujdestarëve U buzëqesh kujdestarëve (deri në 6 javë)
4 muaj	Buzëqesh, participon dhe vokalizon me kujdestarët e tij
6 muaj	Fillon të shfaq interes për bebet e tjera, qeshet Bëhet më i interesuar për interaksion social, varësisht nga koha e kaluar me fëmijë të tjerë dhe nga karakteri i tij. Shfaq frikë nga të panjohurit dhe shqetësohet nëse ndahet nga kujdestari i tij Komunikon ndryshe me anëtarë të ndryshëm të familjes Përdor sende për rehati, si fjala bie, batanije Kërkon vëmendje
9 muaj	Është shumë i interesuar për gjithçka përreth tij. Dallon persona të njohur dhe të panjohur Shfaq shqetësim të pazakonshëm
1 година	Është më këmbëngulës dhe më imponues, si dhe emocionalisht i ndryshueshëm Mund të fillojnë zbrazje të tërbimit Pikëllohen nga rutinat e ndryshueshme Tërbohet kur i thuhet “jo” Bën dallim ndërmjet vetes dhe të tjerëve, por ende është egocentrik – i përqendruar vetëm në pikëpamjen e tij ndaj botës Shpreh emocione të caktuara dhe është i vetëdijshëm për emocionet e të tjerëve Mund të luajë vetë Fillon ta zhvillojë qëndrueshmërinë e sendeve
18 muaj	Nuk e pëlqen ndryshimin e rutinës Mësohet ta përdor oturakun Kur shqetësohet, ka zbrazje të hidhërimit Ka ndjenjë të caktuar për veten e tij – është egocentrik Nuk dëshiron të këmbëjë me të tjerët, por ka ndjenjë të fuqishme të pronësisë “e imja”

MOSHA	ZHVILLIMI SOCIAL DHE EMOCIONAL
2 vjeç	<p>Kënaqet në shoqëri me fëmijët e tjerë, por nuk ka dëshirë t'i këmbejë lodrat</p> <p>Mund të brengoset kur një fëmijë tjetër është i shqetësuar</p> <p>Inkuadrohet në lojë paralele (me të tjerët)</p> <p>Mbetet egocentrik</p> <p>Emocionalisht bëhet stabil, po ende shfaq prirje për ndryshime të disponimit</p> <p>Mësohet të ndahet nga kujdestari për një periudhë të shkurtër, p.sh. derisa është në foshnjore</p> <p>E di identitetin e tij</p>
3 vjeç	<p>Shfaq ndjenjë më të madhe sociale</p> <p>Do të luante në grup me dy ose tre vetë, duke këmbyer ide</p> <p>Mund të ketë miq të afërt</p> <p>Djemtë dhe vajzat shpesh luajnë bashkë</p> <p>Është i fuqishëm dhe emocionalisht i sigurt</p> <p>Është dorëdhënës ndaj fëmijëve të tjerë</p> <p>Është gjithnjë më i pavarur, por ende ka nevojë për mbështetjen e të rriturve</p> <p>Frikohet të mos i humbë kujdestarët</p> <p>Ka ndjenjë të fuqishme të identitetit gjinor</p> <p>Shqetësohet pak nga ndarja</p> <p>Luan me të tjerët</p>
4 vjeç	<p>Kënaqet në lojë të përbashkët dhe shqetësuese</p> <p>E kupton bashkëpunimin dhe garën</p> <p>Reagon ndaj argumentimit</p> <p>Mund ta ndjekë rendin</p> <p>Ka pavarësi, por ende ka nevojë për ngushëllim dhe bindje</p>
5 vjeç	<p>Preokupohet me aktivitete</p> <p>Zhvillon frikë nga lugetërit, qeniet nën krevat</p> <p>Është i brengosur se nuk do të pëlqehet nga të tjerët</p> <p>Është zhvilluar ndjenja e vetëdijes/ndërgjegjshmërisë</p>
6–7 vjeç	<p>Mund të krijojë miqësi të fuqishme</p> <p>Ofron mbështetje të madhe, luan lojëra të ndërlikuara</p> <p>Luan në grupe të ndara, vajzat me vajza dhe djemtë me djem</p> <p>Është përafërsisht i pavarur i sigurt</p> <p>Shfaq ndjenjë të shtuar të moralizimit (e drejtë dhe e gabuar)</p>
8–12 vjeç	<p>Miqësitë bëhet shumë të rëndësishme – rëndom ndërmjet gjinisë së njëjtë</p> <p>Shfaq brengosje për mendimin që e kanë të tjerët për ata</p> <p>Shpeshherë është i pasigurt për ndryshimet në mjedisin e tij</p>
13–16 vjeç	<p>Ndryshimet në trup mund ta shqetësojnë vetërespektin</p> <p>Duhet të zgjidhen ndryshimet e pjekurisë</p> <p>Disa janë më të sigurt për ndryshimet në mjedis</p> <p>Më shumë dëshiron të jetë me miq sesa me familjen</p> <p>Presioni nga moshatarët ka ndikim të konsiderueshëm</p>

Loja e pavarur (loja me të shtirur) ose loja kreative është shumë e rëndësishme për zhvillimin social dhe emocional të fëmijëve. Fëmijët, me lojën e tyre, “do t’i realizojnë” ngjarjet që i kanë shijuar.

ZHVILLIMI I KOMUNIKIMIT DHE TË FOLURIT

Fëmijët komunikojnë qysh para se të lindin. Bebja në mitër reagon ndaj zhurmës ose shqetësimit të fuqishëm duke lëvizur. Fëmija i porsalindur komunikon përmes qarjes dhe sigurisë duke i shtuar nazet. Nuk ka nevojë për kohë më të gjatë për kujdestarin që ai ta dallojë qarjen e ndryshme: të urisë, të lodhjes, të të ftohtit, të ngopjes, të nevojës për përqaftim etj. Dëgjoni se si prindi i flet bebes së tij – sigurisht do të dëgjoni se ai përdor formë të thjeshtë të folurit, ndërlikimi i së cilës zhvillohet ashtu siç zhvillohet të folurit te fëmija. Kjo quhet “të folur i bebes”.

Vëzhgoni një grup fëmijësh se si luajnë në shtëpi ose në fushë të lojës. Në shtëpi mund ta shihni se si fëmija “shoqërohet” me kukull ose si e merr rolin e nënës ose të babait.

Shpejtësia e pasurimit të fjalorit është e jashtëzakonshme. Deri në tetë vjeç fëmija do të murmurisë tinguj si “dada”, deri në 18 muaj do të përdorë 30 deri në 40 fjalë, ndërsa deri në vitin e tretë të jetës do të formulojë fjali të përbëra. Shpejtësia e këtij zhvillimi varet nga shumë faktorë, të cilët përfshijnë ndonjë aftësi të lindur që të zhvillohet të folurit, por po ashtu varet edhe nga ajo se sa i drejtohet konverzacioni fëmijës. Noam Çomski (gjuhëtar) është personaliteti kryesor për zhvillimin e idesë se qeniet njerëzore kanë aftësi të lindur për të folur.

Ka lidhje direkte ndërmjet shkallës së fjalorit të fëmijës dhe asaj se sa i ka folur nëna fëmijës gjatë vitit të parë. Fëmijët, nënat e të cilëve u kanë folur shumë, mund të përdorin dy herë më shumë fjalë kur janë 17-muajsh për dallim prej fëmijëve të cilëve nuk u është folur shumë.

Vëzhgoni një grup fëmijësh se si luajnë dhe përpikuni ta kuptoni se çka ndodhë pa e dëgjuar se çka flasin ata.

Çka bënë përveç që luanin? Duhet të vëreni se përdorin:

- shprehje të fytyrës
- të folur të trupit
- shkathtësi të dëgjimit
- intonacion të ndryshëm

Komunikimi joverbal ka domethënie të njëjtë edhe për fëmijët edhe për të rriturit. Në fakt, fëmijët e përdorin atë më shumë se të rriturit.

Të folurit është një aspekt i zhvillimit, i cili mund të ndryshojë gjerësisht pa pasur lidhje me aspektet e tjera zhvillimore ose me inteligjencën e fëmijës. Prindërit shpeshherë janë shumë të brengosur nëse fëmija fillon të flasë më vonë, në krahasim me vëllain ose motrën më të moshuar.

Shkaku i kësaj mund të jetë i thjeshtë: fëmija më i rritur i parashikon qysh më parë nevojat e fëmijës më të vogël, duke e mënjanuar nevojën urgjente që fëmija të flasë ose për arsye se ai fëmijë thjesht do të flasë më vonë.

Zhvillimi i të folurit ndahet në dy faza të ndara:

- **Paralinguale:** kjo fazë është deri në muajin e 12-të, kur fëmija fillon t’i shprehë fjalët e tij të para.
- **Linguale:** fjalët tash përdoren me kuptim

MOSHA	SHKATHËSITË E TË FOLURIT DHE SHKATHTËSITË KOMUNIKATIVE
Faza paralinguale	Lindja deri në 12 muaj
Lindja deri në 4 javë	Qan kur ka nevojë për vëmendje në lidhje me nevojat themelore, si p.sh.: uri, lodhje, shqetësim
1 muaj	“Ngrin” kur afër veshit të tij bie zilja lehtë, e kthen kokën kah tingulli Ndal së qari kur dëgjon tingull të zërit të njeriut (pos, nëse është shumë i shqetësuar). Gugon si reagim ndaj asaj që i flet kujdestari.
3 muaj	Qetësohet dhe e kthen kokën kah tingulli i trokitëses në afërsi të kokës Kur dikush i flet dhe kur është vetë, vokalizon
6 muaj	Artikulon tinguj monotonë, si p.sh.: “aah-aah”, “guu” Kur luan, buzëqesh, qeshet dhe bërtet me zë të lartë. Reagon ndryshe ndaj toneve të ndryshme të zërit Fillon të reagojë ndaj tingujve jashtë fushës së shikimit të tij, me reagim të rregullt vizual
9 muaj	Vokalizon për komunikim, bërtet për vëmendje Mërmërit me zë dhe në mënyrë melodike përdor rrokje në vargje të gjata, si p.sh.: “ta-ta”, “baba”, “ma-ma”. Imiton vokale të tingujve të rriturve, si p.sh.: kollitje, lëpirje të buzëve Kupton “jo” dhe “çao” Shfaq reagim të shpejtë ndaj testit të dëgjimit të realizuar 1 metër pas fëmijës, jashtë fushës së shikimit të tij.
1 vit	E di emrin e tij Mërmërit me zë në biseda, inkuadron shumicën e tingujve të vokaleve Kupton rreth 20 fjalë në kontekst, si p.sh. filxhan, qen, darkë dhe kupton mesazhe të thjeshta, si p.sh.: “duartrokit”, “ku i ke këpucët?”
Лингвална фаза	12–18 muaj
12-18 muaj	Paraqiten fjalët e para; përdor 6-20 fjalë të panjohura, ndërsa kupton më shumë I përsërit fjalët e rëndësishme dhe fjalët e fundit në fjali Përpiqet të inkuadrohet në këngët për fëmijë Përgjigjet në udhëzime të thjeshta: “bjeri këpucët”, “mbylle derën”.
18-24 muaj	Përdor dy fjalë të lidhura bashkë Përdor më shumë se 200 fjalë të moshës 2-vjeçare Formon fjali të thjeshta nga dy fjalë E përmend emrin e tij, flet me veten e tij gjatë lojës Ka të folur telegrafik, përkatësisht përdor fjalë esenciale themelore dhe heq dorë nga fjalët lidhëse
2–3 vjeç	E shton shpejt fjalorin, duke inkuadruar edhe shumësin Ka biseda të thjeshta Kënaqet në përsëritjen e përrallave të dëshiruara Numëron deri në dhjetë

MOSHA	SHKATHTËSITË E TË FOLURIT DHE SHKATHTËSITË KOMUNIKATIVE
Лингвална фаза	12–18 muaj
3–4 vjeç	E imiton të folurit e të rriturve Mund të kuptohet nga të panjohurit Formon fali të shkurtra dhe të drejta gramatikore Parashtron shumë pyetje të tipit: çka?; pse?; dhe si? I di pjesët e trupit dhe kafshët Ende bën gabime në përdorimin e kohëve
4–8 vjeç	ë folurit është i rrjedhshëm dhe i drejtë, përdor të folur përshkruar E thotë emrin e plotë, moshën, ditëlindjen dhe adresën Kënaqet në mahi, këngë, rimë etj. E mban mend shpejt fjalorin – 5.000 fjalë deri në moshën 5-vjeçare Njeh fjalë të reja dhe pyet për kuptimin e tyre I kopjon me besnikëri akcentet e dëgjuara E shqipton shumicën e tingujve me pak vështirësi e me disa fjalë
8 vjeç dhe më vonë	dhe më vonë Shumica e fëmijëve janë oratorë, lexues dhe shkruar të rrjedhshëm të gjuhës së tyre. Rritet përdorimi i të folurit të shifruar, kjo nën ndikimin e moshatarëve.

ZHVILLIMI INTELKTUAL

Zhvillimi kognitiv ose intelektual ka të bëjë me atë se si fëmijët mësojnë, mendojnë ose krijojnë ide. Kjo është njëra nga sferat zhvillimore, e cila është nën ndikim të madh të përvojave që i ka pasur fëmija. Emrat e kafshëve mund të mësohen vetëm nëse i janë treguar fëmijës. Kjo ka të bëjë me thuaja secilën dituri ose shkathtësi.

Ekzistojnë shumë hulumtime për atë se si i zhvillojnë fëmijët shkathtësitë intelektuale. Këtu më poshtë vijnë dy teori më të njohura:

- **Pijazhe** dëshmoi se inteligjenca është rezultat i rendit natyror të fazave dhe se ajo zhvillohet si rezultat i lidhjeve ndërmjet fëmijës dhe mjedisit të tij jetësor. Fëmija krijon “skema” që ato t’i ndihmojnë në zgjidhjen e problemeve në mjedisin e tij jetësor. Për shembull, mendohet se të gjithë qentë janë të zi nëse ledhataku i fëmijës në shtëpi është qen i zi, ndërsa qeni i bardhë kërkon skemë që do të ndryshojë nga ajo.
- **Bruneri** besonte se ashtu si fëmijët zhvillohen, përdorin edhe mënyra të ndryshme që

ta shprehin botën përreth tyre. Paraqitja aktive e përfshin mënyrën se si ata e përshkruajnë botën e tyre me veprime shqisore-motorike, përkatësisht me përdorimin e trupave të tyre – mendoni si do të mund të përshkruanit qarkun ose shkallët rrethore pa i përdorë duart ose trupin! Paraqitja ilustruese i përshkruan fotografitë në mendje – mendoni se si do t’ia shpjegonit mikut tuaj se ku keni qenë në pushim – shpeshherë fotografia ose piktura janë mënyra më e lehtë e këtij përshkrimi. Faza e fundit dhe e pjekur është semantika, kur fëmija mund ta përdor gjithë njohjen e të folurit që me të t’i përshkruajë dhe diskutojë informacionet

Ka shumë mundësi që disa aspekte të secilës nga teoritë e dhëna të luajnë rol në atë se si zhvillohen fëmijët në aspekt intelektual. Është e padiskutueshme se fëmijët në aspekt intelektual zhvillohen me shpejtësi të ndryshme dhe në sfera të ndryshme. Nuk është krejt e qartë se pse disa fëmijë bëhen shkencëtarë, e disa të tjerë bëhen artistë, por është krejt të arsyeshme të supozohet se përvoja luan rol të madh, njësoj si edhe shkathtësitë e trashëguara.

MOSHA	ZHVILLIMI INTELEKTUAL
Lindja	I dridh qerpikët si reagim ndaj dritës së fuqishme Kthehet nga drita e dobët Ia ngul sytë kujdestarit Qan kur duhet t'u kushtohet kujdes nevojave të tij themelore
1 muaj	I ngul sytë në dritë të dobët Syri i tij e rrok dhe e ndjek topin që lëkundet
3 muaj	E ndjek lëvizjen e sendeve më të mëdha dhe më të vogla
6 muaj	Është shumë kureshtar, lëvizjet ia tërheqin vëmendjen shpejt Menjëherë e fikson shikimin në gjëra të vogla në afërsi, shtrihet t'i kapë. Gjithçka fut në gojë Shikon se si lodrat bien nga dora në fushën e kap syri i tij
9 muaj	Shikon në drejtimin e vërtetë të lodrave që bien
12 muaj	I hedh qëllimisht lodrat dhe i shikon se si bien, procesi i a.q. "derdhja" I kërkon në një vend të dukshëm lodrat që janë rrokullisur dhe kanë rënë nga fusha e shikimit të tij I dallon njerëzit e njohur në largësi prej 6 metrash
18 muaj	Ndërton kullë nga tre katrorë, kur për këtë mësohet I shfleton faqet e librave, nga disa në kohë të njëjtë, kënaqet me ilustrime dhe mund ta shprehë një send që përmendet I tregon sendet interesante që janë jashtë I tregon pjesët e trupit
3 vjeç	Vizaton rreth dhe kryq, vizaton njeri me kokë Çifton dy ose tre ngjyra themelore Vizaton me brushë të madhe, pret me gërshërë
Deri në 5 vjeç	Vizaton katror dhe shkronja të caktuara – disa i bën spontanisht Vizaton njeri me kokë, trup, duar dhe karakteristika, mund të vizatojë shtëpi I ngjyros me kujdes fotografitë I emërton ngjyrat themelore dhe çifton dhjetë ose më shumë ngjyra E di kohën e aktiviteteve themelore, p.sh.: kafjallin, kohën për gjumë I çifton simbolet, shkronjat dhe numrat Zgjedh ndërmjet sendeve më të lehta dhe më të vështira I kupton fjalët "para, prapa, pranë" Numëron përmendsh deri në 20
Deri në 6 vjeç	E zhvillon aftësinë për të shkruar, mund të shkruajë disa fjalë dhe të kopjojë disa të tjera Lexon libra të thjeshta Shtohet eleganca për të vizatuar dhe pikturuar E di ditëlindjen e tij Shkruan dhjetë ose më shumë fjalë Mund t'i parashikojë ngjarjet që vijnë Mund të numërojë deri në 100 E di se çka është e plotë e çka është përgjysmë

MOSHA	ZHVILLIMI INTELEKTUAL
6–8 години	Mund ta kuptojë konceptin, fjala bie, se sasia e plastelinës mbetet e njëjtë edhe nëse topin e plastelinës e kthejmë në forma të ndryshme: të gjatë, gjarpër të hollë. E zhvillon aftësinë e të menduarit për disa gjëra njëherazi Kënaqet në lojëra dhe rregulla E kupton përdorimin e simboleve në matematikë, shkrim etj. Shfaq kureshtje të madhe në lidhje me punën në mjedisin e tij
8–12 години	Mund të rezonojë dhe të zbatojë logjikë në zgjidhjen e problemeve Mund t'i përcjellë informacionet nga njëra situatë dhe t'i shfrytëzojë ato në tjetrën Bëhet më kreativ në lojë Lexon dhe shkruan plot vetëbesim E rrit prirjen për disa tema
13–16 години	E zhvillon aftësinë për të menduarin abstrakt I studion burimet e informacioneve Bëhet i vetëdijshëm për botën Shfaq prirje të qartë ndaj artit ose shkencës Mendon për zgjedhjen që ka të bëjë me arsimin dhe karrierën e ardhshme

PJEKURIA

Mund të dëgjoni ose të lexoni për “pjekurinë” në lidhje me rritjen dhe zhvillimin. Pjekuria nënkupton njeri plotësisht të rritur dhe të zhvilluar. Të rriturit konsiderohen si formë e pjekur e njerëzve. Shpeshherë keni dëgjuar disa njerëz të quhen “të papjekur”. Pse disa njerëz të rritur janë më të pjekur se të tjerët?

Kthehuni më sipër në teoritë e zhvillimit, sepse shumica e tyre janë të bazuara në idenë se ne, fjala bie, mësojmë përmes përvojës. Një pjesë e madhe e zhvillimit po ashtu varet nga “programimi” jonë i lindur, por ajo duhet të zhvillohet edhe më tej përmes përvojave tona. Për shembull, ne të gjithë jemi të programuar të mësohemi të flasim, por se si do të flasim, kjo është modeluar, për shembull, nga ajo që e dëgjojmë dhe si na flitet neve.. Nuk ka nevojë për fantazi të madhe që të kuptohet se cilësia e asaj që e dëgjojmë mund të jetë e rëndësishme

Sjella e përgjithshme, po ashtu, është e modeluar nga përvojat e tona – ka shumë mundësi që fëmija që gjithnjë i shikon prindërit e tij se si sillen me kujdes dhe vëmendje ndaj të tjerëve, edhe të rritet në atë mënyrë. Mbani mend, përvojat mund të jenë edhe pozitive edhe negative.

Nëna e një fëmijë ishte shumë e brengosur për të folurit e djalit të saj. Ai është katër vjeç dhe thuaja në secilën fjali përdor fjalor ofendues. Megjithatë, biseda e saj me edukatoren në foshnjore e zbuloi arsyen e kësaj:
– secilën fjalë që e shprehte ajo, përmbante fjalor të njëjtë për të cilin ajo ishte ankuar se e përdorte djali i saj. Edukatorja ishte përpjekur t'ia shpjegojë se fëmijët mësojnë të flasin përmes shembujve.

Një aspekt i pjekurisë është ajo që të rriturit e presin nga fëmijët. Mbështetja e mirë në këtë pjesë, për shembull, është mundësuar nga të rriturit që e dinë se çka është reale të pritët nga fëmija në atë moshë ose fazë zhvillimore. Përkundrazi, nëse të rriturit presin nga fëmija të bëjë gjëra që janë mbi fazën e tij zhvillimore, ai mund të ofrojë rezultat të dobët.

Ne i vështruam të gjitha elementet më të rëndësishme të zhvillimit. Prandaj është me rëndësi të mbahen mend principet themelore:

- Asnjë aspekt i zhvillimit nuk zhvillohet në mënyrë të pavarur;
- Zhvillimi është proces gradual dhe i njëpasnjëshëm. Ne jemi të programuar të mësojmë shumë shkathtësi, si për shembull, të ecim

dhe të argëtohem sipas atij rendi, por me shpejtësinë e njëjtë;

- Shumë gjëra mund të ndikojnë në shpejtësinë e zhvillimit dhe, ndonëse ekzistojnë kthesa në zhvillim, me rëndësi është të mbahet mend se të gjithë janë individë të veçantë dhe se do të pihen me shpejtësinë e tyre.

CILËT FAKTORË NDIKOJNË NË RRIJTJEN DHE ZHVILLIMIN?

Rritja dhe zhvillimi varen nga shumë faktorë: disa kanë më shumë ndikim ndaj disa fëmijëve, e disa më pak ndaj disa fëmijëve të tjerë. Ndikimi mund të jetë pozitiv dhe negativ. Për shembull, e kundërta e varfërisë është pasuria; fëmija që rritet në shtëpi pa probleme financiare, mund të jetë i ushqyer dhe i veshur më mirë dhe të ketë shumë mundësi për zhvillim arsimor. Megjithatë, këto privilegje mund ta humbin ndikimin e tyre nëse fëmija nuk ka familje të mbushur me dashuri dhe përkrahje.

Varfëria


Njerëzit që kanë 60% më pak të ardhura se ajo që e pret një njeri mesatar mund të konsiderohen se janë në rrezik të varfërisë ose përjashtimit social.

Grupet kryesore që e kanë patjetër të jetojnë me mjete shumë të pakta financiare, përfshijnë familjet me një prindër, njerëzit që janë të papunë, njerëzit e moshuar, njerëzit që janë Familjet që janë të varfra mund të kenë mjete

financiare të mjaftueshme për ushqim, ndonjë veshje dhe mundësi për ngrohje, por varfëria do të thotë se nuk ka më shumë mjete për furnizime interesante dhe stil interesant të jetës. Familjet që varen nga ndihma sociale kanë zgjedhje të kufizuara në jetë. Veshja më moderne, makinat e sigurta, pajisja elektronike bashkëkohore, pushimet vjetore etj., mund të mos jenë zgjedhje për njerëzit me të ardhura të ulëta. Familjet me mjete të pakta financiare patjetër duhet të kufizohen në atë që mund ta blejnë kur shkojnë në supermarket ose në qendër shoppingu.

Problemet e mëposhtme i pengojnë njerëzit (e me këtë edhe fëmijët) që ta shfrytëzojnë më së miri atë që u ofrohet në jetë:

- **Недостаток од можности за работа.** Работата е најважниот начин да се излезе од ниските примања. Но последиците од невработеноста не се одразуваат само како недостаток на средства. Тоа може да доvede и до лошо здравје и да ги потисне идните можности за вработување;
- **Недостаток од можности за стекнување на образование и квалификации.** Многу поголеma е веројатноста дека возрасните без основни квалификации ќе поминат долго Копа без работа;
- **Сиромаштија во детството.** Со ова се поврзани проблемите со niski приходи, лошо здравје, лоши услови за живеење и небезбедни животни средини;



Varfëria mund të sjellë në probleme të ndryshme. Për shembull, nëse jeni me të ardhura të ulëta, jetoni në lagje të varfër; nëse jetoni në lagje të varfër, mund të keni me shumë frikë nga kriminaliteti

- **Mungesa e mundësive për punë.** Puna është mënyra më e rëndësishme që të dilet nga të ardhurat e ulëta. Por, pasojat e papunësisë nuk shprehen vetëm si mungesë e mjeteve. Kjo mund të shpijë edhe në shëndet të ligë dhe t'i ndrydhë mundësitë e ardhshme për punësim;
- **Mungesa e mundësive për arritjen e arsimit dhe kualifikimeve.** Ka shumë mundësi që të rriturit pa kualifikime themelore të kalojnë një kohë të gjatë pa punë;
- **Varfëria në fëmijëri.** Me këtë janë të lidhura problemet e të ardhurave të ulëta, shëndeti i ligë, kushtet e këqija për jetë dhe mjediset e pasigurta jetësore;
- **Familjet e shthurura.** Dëshmitë flasin se fëmijët e familjeve me një prindër do të vuajnë nga pasojat e të ardhurave të ulëta në vazhdimësi në amvisëritë e tyre. Stresi në familje mund të sjellë përjashtim social, ndërsa në raste ekstreme edhe deri në gjendje të pas-trehë;
- **Pabarazia shëndetësore.** Shëndeti mund të rrezikohet nga të ardhurat e ulëta dhe disa faktorë socio-ekonomikë, siç është qasja në shërbime cilësore shëndetësore dhe në shitore, në të cilat shitet ushqim cilësor me çmime të kapshme;
- **Kushtet e këqija për jetë.** Kjo ndikon drejtpërdrejt ndaj cilësisë së jetës së njerëzve dhe shpie drejt një varg problemesh shëndetësore fizike dhe mendore, ndërsa njëherazi mund të shkaktojë edhe vështirësi për fëmijët që përpiqen t'i bëjnë detyrat e shtëpisë;


Jeta e pritur e një fëmije të lindur në familje ku prindërit janë profesionistë (p.sh. mjek ose kontabilist) është shtatë herë me e gjatë se e fëmijës së lindur në kohën e njëjtë, por në familje pa kualifikime. Mundësitë që fëmijët e atyre familjeve të bëhen viktimë të fatkeqësive janë 5 herë më të larta, ndërsa mundësitë që të bëhen viktimë të zjarrit janë 15 herë më të larta.

- **Lagjet e varfra.** Rajonet më të varfra vuajnë nga kushtet e këqija për jetë, nga shkalla e lartë e kriminalitetit, nga papunësia, shëndeti i ligë dhe përçarjet në familje.

Mjedisi jetësor

Familjet që ndjejnë siguri për të ardhurat dhe financat e tyre të ardhshme mund ta zgjedhin stilin e jetës së tyre. Ato po ashtu mund të zgjedhin se ku do të dëshironin të jetojnë. Familjet e klasave më të larta sociale rëndom jetojnë në lagje më të pasura me infrastrukturë të mirë rrugore dhe institucione të mira arsimore. Familjet me të ardhura të ulëta rëndom jetojnë në lagje të dendura. Familjet me të ardhura të ulëta rëndom janë të detyruar të jetojnë me qira, në vend se ta blejnë shtëpinë e tyre. Grupet e ndryshme të klasave sociale rëndom jetojnë në fqinjësi të ndryshme.

A është e rëndësishme se në çfarë lokacioni jetoni? Shumë njerëz do të thoshin se ajo që është e rëndësishme është që të pajtoheni me njerëzit me të cilët jetoni dhe se paratë ose madhësia e shtëpisë suaj nuk janë të rëndësishme. Por, ekzistojnë dobësi nëse jetoni në objekte banesore jociësore ose me më shumë banorë. Aty ka zhurmë, ndotje, rrëmujë, qasje të vështirë në shitore dhe objekte të tjera, si dhe stres për shkak të pranisë së veprave më të vogla penale (kundërvajtje) Kur njerëzit janë



Problemet e krijuara si rezultat i jetës në objekte me shumë banorë.

me të ardhura të ulëta, mbajtja e shtëpisë mund të jetë vërtet problem. Shtëpia që mbahet keq mund të krijojë rrezik për shëndetin.

Mendoni për kushtet banesore në rajonit tuaj. A janë të ndryshme në pjesë të ndryshme? Ndoshta duhet të shëtiteni nëpër lagje që t'i shihni objektet. A konsideroni se stili i të jetuarit të familjeve në rajonin tuaj dallohet në objekte të ndryshme banesore?

Të ardhurat e pakta dhe kushtet jo të mira banesore për shumë njerëz janë burim i stresit. Tabela e mëposhtme i paraqet përqindjet e pronarëve të shtëpive që janë ankuar se kanë probleme me temat e theksuara në kolonën e majtë. Në përgjithësi, duket se njerëzit me mjete financiare kanë më pak probleme në krahasim me njerëzit që jetojnë në kushte më të varfra. Jeta në periferi ose në brendi po ashtu mund të shkaktojë më pak stres se jeta “në qytet”

Mendoni për kushtet banesore në rajonit tuaj. A janë të ndryshme në pjesë të ndryshme? Ndoshta duhet të shëtiteni nëpër lagje që t'i shihni objektet. A konsideroni se stili i të jetuarit të familjeve në rajonin tuaj dallohet në objekte të ndryshme banesore?

Struktura familjare

Shumë njerëz jetojnë si çift, me fëmijët e tyre, por do të ishte gabim të mendohet se të gjithë njerëzit janë të lindur dhe të rritur në familje të vogla.

Familja është grup social i përbërë nga njerëz që janë “në faqesni” mes vete. Kjo do të thotë se njerëzit e tjerë (shoqëria) pranojnë se ky grup është në faqesni. Përkatësia ndaj një familjeje mund të ketë shumë përparësi. Lidhjet familjare mund të mundësojnë mjedis të sigurt dhe të kujdesshëm për fëmijët. Grupet familjare mund t'u prijnë dhe mësojnë fëmijët, ato mund të sigurojnë burim të mbështetjes sociale dhe emocionale për të rriturit dhe anëtarët më të moshuar të familjes, si dhe për fëmijët.

Sociologët i kanë identifikuar katër lloje të ndryshme të familjes:

- familja më e gjerë
- familja bërthamë (bashkëkohore)
- familja e përzier
- familja me një prind.

Familja më e gjerë

Familje më e gjerë është ajo në të cilën jetojnë bashkë ose në afërsi prindërit, fëmijët dhe gjyshi e gjyshja, andaj shpeshherë janë bashkë. Familja më e gjerë mund të ketë shumë përparësi. Për shembull, prindërit mund të punojnë tërë ditën pa u brengosur se kush kujdeset për fëmijët – gjyshi e gjyshja mund ta bëjnë atë. Nëse gjyshi e gjyshja kanë nevojë për kujdes, atëherë prindërit ose edhe fëmijët më të rritur mund të ndihmojnë. Familja më e gjerë mundëson një rrjet të tërë të njerëzve që japin mbështetje.

Analiza

Jeta me familje

Roberti jeton me vëllain, nënën dhe babanë e tij në shtëpinë dykatëshe në afërsi të qendrës së qytetit. Prindërit e nënës së Robertit jetojnë në katin e parë të shtëpisë. Ata kanë banjo dhe kuzhinë të tyre, ndonëse ndonjëherë gjithë familja ha bukë bashkë gjatë fundjavave.

Prindërit e Robertit kishin mundësi t'ia lejojnë vetes të blejnë shtëpi të këtyllë, sepse gjyshi e gjyshja e shitën shtëpinë e tyre që ta mundësojnë këtë

Familja bërthamë (bashkëkohore)

Bërthama është qendra e qelizës së gjallë, ndërsa familja bërthamë është qendra e familjes së gjerë. Termi bërthamë (nukleus) është menduar që ashtu të përshkruhet kjo familje e re më e vogël. Familja origjinale bërthamë është përbërë nga bashkëshorti, që shkon në punë, bashkëshortja, që kujdeset për fëmijët derisa janë të vegjël, dhe fëmijët.

Në kohën tonë shumë çifte nuk i përgjigjen këtij përshkrimi. Tash shpeshherë të dy prindërit punojnë me orar të plotë, ndërsa fëmijët janë nën kujdes të dadove, edukatorëve ose çerdheve. Rolet e meshkujve dhe të femrave janë ndryshuar. Fjala bie, meshkujt dhe femrat shihen njësoj përgjegjës për punët

rreth shtëpisë. Megjithatë, hulumtimet kanë dëshmuar se gratë ende e kanë pjesën më të madhe të përgjegjësisë për kujdesin ndaj fëmijëve, si dhe për punët e shtëpisë.

Analiza

Gjyshet dhe gjyshërit

Mina jeton me motrën, nënën dhe babanë e saj në shtëpi tredhomëshe. Gjyshja e Minës (nga ana e nënës) jeton jashtë vendit dhe ajo nuk e ka parë atë dy vite. Prindërit e babait të saj jetojnë 120 km më

larg dhe secilin vit i sheh pesë deri në shtatë herë. Familja e Minës është shpërngulur në këtë shtëpi para tre viteve, kur babai gjeti punë më të mirë.

Familja e përzier

Në kohën tonë thuaja secila martesë përfundon me divorc. Shumë njerëz të rinj jetojnë bashkë para martesës dhe kanë fëmijë, por ekzistojnë shumë dëshmi se një numër i madh i këtyre çifteve po ashtu ndahen. Më shumë se një e treta e martesave secilin vit janë martesa të dyta, ndërsa një numër i madh i fëmijëve jetojnë me njerkun ose njerkën. Po ashtu shumë fëmijë janë dëshmitarë të divorcit të prindërve të tyre para se t'i mbushin 16 vjeç.

Familja e përzier është ajo në të cilën të dy pjesëmarrësit në çift nuk janë prindër të secilit fëmijë në familje. Njëri nga partnerët ndoshta është ndarë nga martesa e parë e tash përsëri është martuar që të krijojë familje të re. Ndonjëherë fëmijët e lidhjeve të ndryshme mund të inkuadrohen në familje të përzier. Kështu njëri nga partnerët mund të ketë qenë "singëll", ndërsa tash është martuar me partner që ka pasur fëmijë nga ndonjë lidhje e mëparshme.

Analiza

Jeta me njerk/njerkë

Sasha jeton me nënën dhe njerkun e tij në shtëpi moderne në një qytet të vogël. Nëna dhe njerku i tij janë martuar tashmë dy vite. Babai "i vërtetë" i Sashës paraqitet secilën të shtunë që të vijë ta marrë Sashën te ai. Babai dhe nëna e Sashës u ndanë para katër viteve. Njerku i tij ka vajzë. Ajo quhet Zorica dhe jeton me nënën e saj 4 km më larg. Sasha e ka njoftuar Zoricën dhe ajo i ka pëlqyer, por Sasha konsideron se njerku i tij më shumë kujdeset për Zoricën se për atë.

Familjet me një prind

Thuaja një e katërta e të gjitha familjeve me fëmijë të mitur janë familje me një prind. 20 për qind e familjeve me fëmijë të mitur janë familje me një prind, me nënë, ndërsa vetëm 2 për qind janë me baba.

Ndonëse disa familje me një prind mund të jenë financiarisht stabile, ka shumë prej tyre që ballafaqohen me probleme. Një hulumtim ka dëshmuar se numri i familjeve me një prind që jetojnë me të ardhura të ulëta është dy herë më i madh në krahasim me numrin e çifteve me fëmijë të mitur. Shumë prindër të vetmuar shfrytëzojnë ndihmë sociale ose kanë rrogë të vogël.

Analiza

Nëna e vetmuar

Joana është nënë e vetmuar me djalin e saj tetëvjeçar, e cila jeton në katin e katërt të një ndërtese. Ajo kërkon punë me gjysmë orari, por djali i saj ka probleme në shkollë, andaj asaj shpesh i telefonojnë që të shkojë ta marrë djalin ose t'i telefonojë atij. Ajo merr ndihmë sociale.

Ajo nuk ka mjaft para për pushim ose që ta dërgojë diku djalin e saj. Joana nuk mund t'ia lejojë vetes rekreimin që kushton. Në mbrëmje rëndom rri në shtëpi dhe shikon TV. Në lagjen e saj ka shkallë të lartë të kriminalitetit dhe ajo është e brengosur se dikush mund ta sulmojë në banesë.

Familjet që ndryshojnë

Lloji i familjes në të cilën jeton fëmija mund të ndryshojë. Familja më e gjerë mund të shndërrohet në familje bërthamë nëse gjyshja dhe gjyshi vdesin ose shpërngulen. Familjet mund të shndërrohen në "të përziera" nëse njëri partner ikë dhe zëvendësohet me një person tjetër. Shumë pak njerëz mund të garantojnë një lloj të familjes për gjithë jetën e tyre. Kur njerëzit i braktisin partnerët e tyre, shkurorëzohen ose vdesin, mund të krijohen familje me një prind. Nëse prindi i mbetur gjen një partner, familja me një prind shndërrohet në familje të përzier. Fëmija i njëjtë mund të jetojë në strukturë të ndryshme familjare në fëmijëri dhe në rini. .

Të priturat e të rriturve

Inkurajimi i prindërve është i rëndësishëm për zhvillimin e mirë të fëmijës; shumica e prindërve i motivojnë fëmijët e tyre që ta zhvillojnë potencialin e tyre në tërësi. Megjithatë, të priturat më ambicioze mund të kenë edhe pasoja negative ndaj zhvillimit.

Analiza

Zhvillimi i shkathtësive

Jovani 6-vjeçar ishte fëmija më i vogël nga tre fëmijët e tjerë. Vëllai dhe motra e tij ishin shumë të mençur dhe solidë në shkollë. Jovani nuk interesohej për mësimet, ngadalë e mësoi leximin nga vëllai dhe motra e tij, por kishte sjellje miqësore me të gjithë dhe dëshironte të kujdeset për fëmijët e vegjël. Prindërit e tij u brengosën shumë dhe angazhuan ndihmë për çështjen e leximit. Ai çdo mëngjes qante para se të shkojë në shkollë dhe ankohej për dhimbje në bark. Gjërat u përkeqësuan ashtu që ai, në vend se të jetë djalë i këndshëm e i lumtur, u bë një djalë i heshtur dhe i dëshpëruar. Arsimtari i tij i ftoi prindërit dhe u tha se të gjithë fëmijët zhvillohen me shpejtësi të ndryshme, ndërsa presioni i madh mund ta ngadalësojë zhvillimin e shkathtësive. Në këtë mënyrë, pasi që prindërit e tij e pranuan atë me kualitetet që i kishte, i ndërprejnë orët për mësimin e leximit dhe e ndalë presionin ndaj tij, Jovani përsëri filloi të përparojë.

Pasoja nga invaliditeti ose dëmtimi i shqisave

Invaliditeti dhe dëmtimi i shqisave, si fjala bie humbja e të parit ose e dëgjimit, mund ta ngadalësojë zhvillimin e disa fëmijëve. Kjo mund të jetë për shkak të mungesës së pjesës esenciale të gjithë pasqyrës së zhvillimit. Nëse mendoni se sa është e rëndësishme që të dëgjohet të folurit e fëmijës para se të fillojë të flasë, nuk është për t'u befasuar nëse ka mungesë në zhvillimin e shkathtësive komunikative. Ekzistojnë qendra speciale

A ka në rajonin tuaj organizata të këtilla? Merrni vesh se cilat janë ato dhe çka punojnë. Për këtë mund të ftoni ndonjë përfaqësues të asaj organizate, i cili do të flasë për punën e tyre pata grupit tuaj.

që punojnë me fëmijë që kanë ndonjë lloj invaliditeti në mënyrë që t'u ndihmojnë atyre në zhvillim.

Promovimi i rritjes dhe zhvillimit

Kohëve të fundit realizohen shumë aktivitete që kanë për qëllim ta pakësojnë numrin e fëmijëve që jetojnë në varfëri dhe ta zvogëlojnë ndikimin e varfërisë ndaj zhvillimit të fëmijëve dhe kështu t'i rrisin shanset për jetë. Shërbime të caktuara që kanë për qëllim t'u ndihmojnë fëmijëve – që nga shërbimet arsimore, shëndetësore e sociale – punojnë bashkërisht me familjet që ashtu ta përmirësojnë ardhmërinë e fëmijëve.

Tani vonë është pranuar se mirëqenia ekonomike dhe faktorët e tjerë kanë ndikim ndaj zhvillimit të fëmijëve. Nevojiten shumë programe që familjeve t'u ofrohet mbështetje dhe t'u ndihmohet fëmijëve që ata të jenë në gjendje më të mirë. Për shembull:

- **Mbështetje financiare.** Pakësimi i tatimeve për familjet, që ashtu t'u ndihmohet në aspekt financiar;
- **Qendrat familjare.** Aty punojnë bashkërisht qendrat arsimore, shëndetësore dhe agjencitë e ndihmës sociale;
- **Fondacioni për fëmijë dhe njerëz të rinj.** Aty punojnë bashkë të gjitha agjencitë e nivelit lokal.

AKTIVITETE PËR VLERËSIM

Aktiviteti për vlerësim 1

Duke punuar me partner ose grup të vogël, mendoni për rritjen dhe zhvillimin. Shkruani se çka nënkuptoni me rritje dhe zhvillim, si dhe me principet për rritjen dhe zhvillimin.

Në një fletë të madhe të letrës ose në tabelë përgjigjuni në këto pyetje:

1. Çka është "holistike" kur bëhet fjalë për rritjen dhe zhvillimin e fëmijëve?
2. Çka mendojmë me termin "të ndërlidhura mes vete"? Mund të vizatoni një diagram të madh që ta ilustroni atë.

Një princip është ai se zhvillimi kryesisht realizohet me radhitje të njëjtë për të gjitha bebet dhe fëmijët

e vegjël, ndonëse shpejtësia mund të jetë e ndryshme për individë të ndryshëm. Bashkë me partnerin ose grupin shkruani një shpjegim të shkurtër për domethënien e asaj që është shkruar.

Po ashtu ka edhe faza dhe radhitje të ndryshme të rritjes dhe zhvillimit.

Cilat janë këto faza të ndryshme? Për shembull, lindja deri në vitin e parë.

Aktiviteti për vlerësim 2

Bëni katër grafikonë si më poshtë, që ashtu të tregoni se si zhvillohen fëmijët në fusha të ndryshme të zhvillimit nëpër faza të ndryshme: :

1. Grafikon që tregon se si fëmijët zhvillohen në aspekt fizik në secilën nga fazat e ndryshme: 0–3 vjeç, 4–7 vjeç, 8–12 vjeç dhe 13–16 vjeç;
2. Grafikon që tregon se si fëmijët zhvillohen në aspekt social dhe emocional;
3. Grafikon që tregon se si të fëmijët zhvillohet komunikimi dhe të folurit;
4. Grafikon që tregon se si fëmijët zhvillohen në aspekt intelektual.

Aktiviteti për vlerësim 3

Mund t'i vëreni dallimet në zhvillimin e fëmijëve të grupeve të ndryshme të moshës.

Duke i përdorë grafikonët e Aktivitetit 2, përshkruani

dallimet në zhvillimin e fëmijëve të grupeve të ndryshme të moshës.

Aktiviteti për vlerësim 4

Bëni listë me të gjithë faktorët që ndikojnë në rritjen dhe zhvillimin e fëmijëve.

Kjo do të jetë një listë përafërsisht e gjatë dhe duhet të përfshijë: shëndetin, trashëgiminë gjenetike, gjininë, prejardhjen dhe strukturën familjare, klasën sociale, bagazhin kulturor, financa, varfërinë, mjedisin jetësor dhe kushtet banesore, invaliditetin, diskriminimin dhe entet siç janë shërbimet shëndetësore që punojnë për (dhe me) fëmijë e persona të rinj. Po ashtu duhet ta inkuadroni edhe pjekurinë dhe faktin se si funksionon ajo nën ndikim të përvojës dhe të priturrave.

Në vijim shkruani disa fjali për secilin nga këta faktorë.

Aktiviteti për vlerësim 5

Shpjegoni se si të ardhurat e të prindërve, statusi shëndetësor dhe të priturrat e prindërve mund të ndikojnë ndaj rritjes dhe zhvillimit të fëmijëve. Mbani mend se, kur shpjegoni diçka, nuk duhet vetëm ta përshkruani. Por, duhet të theksoni se si dhe pse këta faktorë mund të kenë ndikim ndaj fëmijëve.

1.2. KUPTIMI I ROLIT TË VËZHGIMIT TË ZHVILLIMIT TË FËMIJËS NË VENDIN E PUNËS

QËLLIMI I VËZHGIMIT TË KUJDESSHËM

Pse mendoni se shkathtësitë e vëzhgimit janë aq shumë të rëndësishëm në mjedisin për kujdes të fëmijëve?

Tashmë e pamë se sa është i ndërlikuar dhe sa i ndryshueshëm mund të jetë zhvillimi i fëmijës. Prandaj është shumë e rëndësishme që secili që punon me fëmijë të identifikojë nëse fëmija ka probleme dhe a i duhet atij mbështetje plotësues ose të vlerësojë se a është puna me fëmijë efikase apo jo.

Si mund ta vëreni se sa kanë përparuar fëmijët në zhvillimin e tyre dhe pastaj t'i planifikoni aktivitetet ose punën me to, që t'i mbështetni që edhe më tej ta fuqizoni zhvillimin e tyre?

Përgjigjja është përmes shkathtësive për vëzhgim.

Në të ardhmen, kur të krijoni më shumë përvojë në kujdesin me fëmijë, duhet të posedoni shkathtësi të qëndroni në hapësirë me fëmijë dhe, duke i shikuar, të mund t'i dalloni aspektet e zhvillimit dhe përparimit të tyre dhe çfarëdo problemesh të tjera që shkaktojnë brengosje. Kjo është shkathtësi, për të cilën nevojiten shumë vite përvojë, ashtu që vetëm atëherë kuadri me përvojë do të ketë shkak të realizojë vëzhgim specifik të disa fëmijëve.

Vëzhgimi është së shumë se vetëm shikim i thjeshtë – ju në të njëjtën kohë **shikoni** dhe **mendon**. Kështu, për shembull, ju mund të shikoni se si fëmija ndërton katrorë, por tjetër

është ju të shikoni se si ai i lidh e i mban dhe si reagon nëse në afërsi të tij ka ndonjë fëmijë tjetër. Vëzhgimi është shkathtësi, madje shkathtësi e çuditshme. Me të puna me fëmijë është më interesante, ndërsa meqë jeni më të vetëdijshëm për nevojat dhe anët e fuqishme të fëmijës, ai ndihmon që të bëheni punëtor edhe më efikas.

OBJEKTIVITETI

Ekzistojnë disa pika të rëndësishme që duhet të mbahen mend në lidhje me vëzhgimin.

Vëzhgimi është kohë e kaluar vetëm që të evidentohen disa gjëra në lidhje me fëmijën, e pastaj të nxirren përfundime në lidhje me atë që është evidentuar. Ai duhet të jetë **objektiv**. Kjo do të thotë se duhet të paramendoni se kjo është hera e parë që e shikoni fëmijën me qëllim që mos të shpejtoni me përfundime. Është vështirë të harrohet se shpeshherë fëmija paraqet sfidë, por edhe vëzhgimi i mirë mund të ndihmojë në atë që të zbuloni se pse fëmija është “i padëgjueshëm”. Pjesë thelbësore e vëzhgimit është shmangia e krijimit të shpejtë të përfundimeve. Mbani mend se ata që punojnë me fëmijë të vegjël nuk janë mjekë, logopedë dhe psikologë. Me qëllim që t’i shmangeni vlerësimin të gabuar të fëmijëve, gjithnjë është ide e mirë të realizohen disa vëzhgime dhe ashtu të kërkohet nga dikush tjetër ta vëzhgojë fëmijën duke e bërë ndonjë aktivitet. Vëzhguesit mund të fokusohen në gjëra të ndryshme, andaj dikush që ka më shumë përvojë mund të arrijë në përfundim më ndryshe.

BESUESHMËRIA

Vëzhgimet duhet të jenë të **besueshme**. Ko do të thotë se nuk duhet të jenë të këmbëza me askënd tjetër, përveç me personelin ose profesionistët e tjerë (për shembull, psikologë ose logopedë), që duhet t’i dinë rezultatet. Të gjitha të dhënat nga vëzhgimi duhet të ruhen në dosjen e fëmijës. Në dosje ose në letër asnjëherë nuk duhet të shkruani gjëra që nuk

janë të vërteta dhe që nuk janë të bazuara në dëshmi.

Gjithnjë duhet ta keni parasysh qasjen etike

Ku i ruani vëzhgimet, vlerësimet dhe përfundimet e institucionit tuaj? Kush ka qasje në ato?

të vëzhgimit. A ekziston shkak i bazuar për vëzhgimin? Fëmijët nuk janë eksperimente laboratorike; bëhuni i kujdesshëm në realizimin e vëzhgimeve që nuk janë të patjetërsueshme – veçmas nëse fëmija ka nevoja të veçanta ose probleme në sjellje, të cilat shumë shpesh kanë qenë objekt i vëzhgimit. Ndonjëherë, nëse fëmijët e dinë se i vëzhgoni, sjellja e tyre mund të përkeqësohet.

RAPORTIMI PËR VËZHGIMET

Informacionet e rëndësishme nga vëzhgimi duhet të publikohen në mënyrë adekuate. Si student i vëzhgoni fëmijët me qëllim që të mësoni për zhvillimin e tyre. Megjithatë, nëse dëshmoni diçka që nuk është në kuadër të të priturave tuaja, me rëndësi është ta informoni eprorin tuaj për atë, madje sa më shpejt që keni mundësi, që ai/ajo të vendosë se a është e nevojshme të ndërmerren disa aktivitete

Analiza

Mbajtja e besueshmërisë

Josifi sapo ka përfunduar me vëzhgimin e Dimes i cili i ka 4 vjeç. Ai është i bindur se Dimeja ka vështirësi në zhvillimin e të folurit. Si përfundon me këtë, vjen nëna e Dimes dhe Josifi ia tregon asaj teorinë e tij. Nëna befasohet dhe shqetësohet, madje menjëherë shkon të eprori i Josifit

Çka gaboi Josifi?

Shpjegoni se pse është e rëndësishme të mos shpejtohet me përfundime të hershme kur vëzhgohen fëmijët.

Cili proces përdoret në institucionin tuaj për zgjidhjen e një numri të madh problemesh të fëmijës, të cilat vërehen gjatë vëzhgimit?

Që të krijohet pasqyrë gjithëpërfshirës për fëmijët, vëzhguesit duhet të bisedojnë me

Merrni vesh se si institucioni juaj i këmben informacionet me prindërit dhe si i inkuadron ata në procesin e vëzhgimit dhe vlerësimit. Merrni vesh sa herë institucioni juaj i vëzhgon fëmijët në mënyrë rutinore dhe për çfarë qëllimi.

vetë fëmijët dhe me familjet e tyre. Kur fëmijët vëzhgohen, ata mund të jenë më të ndryshëm se zakonisht. Kur janë në shtëpi, të relaksuar dhe me anëtarët e familjes, fëmijët mund të jenë shumë më ndryshe. Kjo do të thotë se, kur është në shkollë, fëmija është shumë i qetë, ndërsa në shtëpi është verbalisht aktiv dhe energjik.

Të gjitha të dhënat nga vëzhgimi duhet të këmbehen me prindërit dhe bashkë me ata të diskutohet me personelin e kualifikuar. Kjo në shkollë mund të bëhet gjatë kohës së mbledhjeve prindërore. Në foshnjore dhe në çerdhe të dhënat nga vëzhgimi mund të këmbehen me prindërit kur ata vijnë ta marrin fëmijën e tyre.

Analiza

Vëzhgimi i sjelljes

Izabella përpiquej ta kuptojë Lukën 3-vjeçar. Ai i shmangej lojës jashtë, në fushën e madhe, megjithëse më parë kënaqej duke luajtur aty. Prandaj ajo e vëzhgoi një kohë se si i bën aktivitetet dhe e kuptoi se ai ka probleme me dorën e djathtë. Për këtë e njoftoi eprorin e saj dhe, pasi që ai shkoi në spital me prindërit e tij, u zbulua se ai e ka lënduar supin e krahut. Pas shërimit, ai përsëri vazhdoi të luajë në rrëshqitëse dhe në luhatëse

METODAT E EVIDENTIMIT TË VËZHGIMEVE

Vëzhgimet mund të jenë formale dhe joformale. Ashtu siç shihet nga vetë shprehjet, vëzhgimi formal është ai që planifikohet qysh më parë dhe që shërben për një qëllim të caktuar. Vëzhgimi joformal është oportunist; ndoshta është i bazuar në vëzhgimin e fëmijës në aktivitete që shprehin aspekte të sjelljes ose të zhvillimit.

Metoda	Si funksionojnë	Dobësitë
Fletët kontrolluese, diagramet	Vëzhguesi është i fokusuar në një aspekt të zhvillimit Ai mund të përdoret te më shumë se një fëmijë në të njëjtën kohë. Mund të përsëritet	Njerëz të ndryshëm mund të arrijnë në rezultate të ndryshme. Fokusi i shkathhtësive që i shfaq fëmija mund të mos e tregojë se sa në të vërtetë fëmija është i dëshpëruar. Fëmijët mund të mendojnë se nuk ia kanë dalë nëse nuk mund ta kryejnë detyrën. Fletët kontrolluese dhe diagramet patjetër duhet të jenë të rëndësishme dhe adekuate për fazën zhvillimore të fëmijës.

Emri i fëmijës Data.....

Datëlindja..... Vëzhgues.....

Fleta kontrolluese zhvillimore

Deri në 12 muaj	Po	Jo	Ndonjëherë
I kap gjërat duke përdorë një gisht dhe gishtin e madh?			
I hedh gjërat nga njëra dorë në tjetrën?			
E kërkon sendin e fshehur nën gotën e plastikës?			
E kërkon personin që i flet?			
Artikulon tinguj melodikë të mërmëritjes si da-da			
Reagon ndaj tingujve të ndryshëm, si p.sh. tupan, zile			
Imiton gjeste si duartrokitja dhe çao			
E mban gotën me dy duar?			
I përdor gishtat që të ushqehet, si p.sh. bukë të prerë në forma katrore?			
I ngre lodrat që kanë rënë?			
Reagon ndaj fjalës „Jo“?			
Reagon ndaj emrit të vet?			

Metoda	Si funksionojnë	Dobësitë
Të dhëna të shkruara/ të shkruar i shpejtë	Përshkrim i shkurtër i asaj që e bën fëmija në kohë të caktuar. Janë të popullarizuar te prindërit e tyre, sepse ofrojnë pasqyrë me shkrim për fëmijën e tyre. Përdoren për evidentimin e një ose më shumë sferave zhvillimore	Vëzhgues të ndryshëm fokusohen në gjëra të ndryshme, andaj është vështirë të përsëritet Duhet të shkruani shpejt që të mund t'i shënoni të gjitha informacionet. Mund të jetë vështirë të gjendet gjuha e vërtetë që të përshkruhet ajo që e shihni.

Radica u ndal para Mihaellës, e cila rri ulur në karrige. Duket se Radica e shikon Mihaellën. Ajo i thotë: “A do të zbukurohem?”. Mihaella pohon me kokë dhe i buzëqesh, ndërsa edhe Radica buzëqeshet, e pastaj të dyja shkojnë në pjesën e veshjeve.

Radica e merr fustanit ngjyrë trëndafili, e kap me dorën e djathtë dhe e vë në dysheme. E zbërthen fustanin nga ana e prapme, duke i përdorë të dy duart. E fut së pari këmbën e djathtë dhe gradualisht e ngre lart derisa nuk drejtohet dhe e fut krahun e djathtë në fustan, e pastaj e fut të majtin.

Radica i afrohet edukatores dhe e shikon. E pyet: A mund të më mbërthesh?” dhe kthehet prapa.

Shembull i shënimit me shkrim për vëzhgimin

Metoda	Si funksionojnë	Dobësitë
Lista e katalogizimit të kohës	Shikoni çka bën fëmija në kohë të ndryshme në periudhë të caktuar kohore, si për shembull, në mëngjes ose në një pjesë të pasdites. Kjo do të thotë se mund të merrni pasqyrë më të plotë për fëmijën. Mund të përdoret për më shumë se një fëmijë ose një a më shumë sfera zhvillimore	Një pjesë e sjelljes ndoshta nuk do të evidentohet nëse ndodhë jashtë kornizës kohore.

Ngjarja	Aktiviteti	Grupi social	Komentet
11.00	Koha për ushqim	Gjithë grupi	Ana rri ulur në karrige, duke luajtur me këmbë. Ajo ha mollë. E mban mollën me dorën e djathtë dhe buzëqeshet. E ngre dorën kur një anëtar i personelit pyet kush do biskotë
11.15	Luajtje përjashta Kornizë për t'u ngjitur/Kornizë e hekurt	Ana dhe Marku	Ana është në rrjetin e sipërm të kornizës së hekurt për t'u ngjitur. Ajo i buzëqesh Markut dhe i thotë: “Ngjitu këtu!”.
11.30	Zhveshja e palltove	Ana, Marku dhe Milani	Ana e zhvesh pallton dhe e nxjerrë njërin krah. Ajo rrotullohet dhe palltoja e saj rrotullohet. Qeshet dhe e shikon Milanin

Shembull i ndarjes së kohës

Metoda	Si funksionojnë	Dobësitë
Lista e katalogizimit të kohës	<p>Përdoren që të shihet se sa shpesh dhe në çfarë rrethanash fëmija shfaq sjellje të caktuar – siç është përshkruar në listë – të plotësohet kur të vërehet.</p> <p>Mund të përdoret nga një ose më shumë vëzhgues.</p> <p>Mund të përdoret që të vëzhgohet sjellja e padëshiruar, siç është goditja.</p> <p>Mund të përdoret që të zbulohet se sa shpesh fëmija flet ose luan me fëmijët e tjerë.</p>	Vëzhguesi ndoshta nuk do të jetë gjithnjë i pranishëm gjatë kohës së sjelljes. Ai mund të harrojë ta përfshijë në listë.

Настан	Кoha	Situata	Grupi social	Dialogu
1	9.16	Kosta qarkullon në afërsi të pikturës	Suzana + 2 fëmijë, tavolinë	A–K „A dëshiron të vish edhe ti dhe të vizatosh diçka?” K–A pohon me kokë
2	9.27	Kosta e përfundon pikturën	Сузана + 2 деца	A–K „Përfundove?” K buzëqesh „Piktura është shumë e bukur. Më thuaj diçka për atë.” K–A „Kjo është nëna ime. Nuk mund ta zhvesh përparësen.” A–K „Prit, unë do të ndihmoj.” Kosta ia jep përparësen Suzanës dhe shkon te pjesa me rërë
3	10.12	Kosta e pret kohën për ushqim/pije	Kosta rri ulur pranë Ahmedit. Jordani i ofron pijet.	A–K „Kosta, qumësht apo qull” K–A „Qumësht.” A–K „A e mbajte mend fjalën magjike?” K–A „Të faleminderit”. A–K „Bravo.”
4	10.19	Kosta e vesh pallton në gardërobë	Jordani + 5 fëmijë	K–A „Nuk mund ta vesh pallton.” A–K „Prit pak. ja. Mund të dalësh.”
5	10.36	Kosta e prej rendin e tij në rrëshqitëse	Jordani + 2 fëmijë	A–C „Bravo. Tash ti e ke radhën.” K buzëqesh K–A „Shpejt do të rrëshqasë teposhtë.”

Shembull i radhitjes së ngjarjeve

Mbani mend – vëzhgimet kanë kufij!

- Vëzhgimet nuk janë të përkryera.
- Ju flasin për fëmijën në atë moment të caktuar dhe në atë gjendje.
- Nëse fëmijët e dinë se i shikoni, kjo mund të ndikojë keq në atë që e bëjnë ata.
- Fëmijët luajnë krejt ndryshe kur mendojnë se

askush nuk i shikon.

- Është vështirë të jeni plotësisht preciz kur vëzhgoni, sepse ka shumë gjëra për të parë. Dy individë që e vëzhgojnë fëmijën e njëjtë mund të shohin përafërsisht gjëra të ndryshme për fëmijën.
- Është vështirë të jesh plotësisht objektiv, veçmas nëse vërehet sjellje e padëshiruar!

Si realizohen vëzhgimet

- Pyeteni gjithnjë eprorin tuaj para se ta realizoni vëzhgimin e fëmijës.
- Vëzhgimet dhe vlerësimet bëni në pajtim me parimet e institucionit.
- Sigurohuni se gjithçka që ju duhet e keni aty pranë.
- Vëzhgoni fëmijët me kujdes dhe pa ju hetuar.
- Vëzhgimet tuaja shkruani në mënyrë të kujdesshme, e cila nuk gjykon.
- Shmanguni nga të shprehurit e çfarëdo mendimi negativ për fëmijët.
- Sigurohuni që të gjitha përfundimet të jenë të bazuara drejtpërdrejt ndaj vëzhgimeve tuaja.
- Këmbeni të dhënat tuaja me eprorin tuaj që ashtu të mund t'ua dorëzoni prindërve.

Analiza

Duke e vëzhguar Gjorgjin

Elena dëshiron të vëzhgojë se a mund të vizatojë Gjergji trevjeçar. Ai ishte i zënë me lojë, por ajo ia ndërpret lojën dhe e fton në tavolinë. Ajo ulet pranë tij dhe i thotë ta vizatojë motrën e tij, Rozën. Gjergji e merr lapsin, e shikon Elenën dhe i thotë se nuk mundet. E pyet se a mund të kthehet dhe të luajë në rërë. Elena i thotë se nuk mundet, e pastaj në fletën e saj e shkruan se ai nuk mund të vizatojë fytyrë njeriu.

1. Shkruani dy shkaqe se pse Gjergji nuk vizatoi fytyrë.
2. Si mund ta bënte Elena më mirë këtë vëzhgim?

AKTIVITETE PËR VLERËSIM

Aktiviteti për vlerësim 6

Mendoni se pse është e dobishme të vëzhgohen fëmijët. Bisedoni për këtë me partnerin tuaj në punë dhe shkruani disa gjëra për shkaqet e vëzhgimit të fëmijëve. Përgjigjja juaj duhet të përfshijë njohje me zhvillimin e fëmijës dhe njohje të nevojave të fëmijës, si për shembull, se fëmija ndoshta është i lodhur ose i sëmurë. Po ashtu ju duhet ta inkuadroni edhe kujdesin për

fëmijën, si fjala bie, të pyeteni se a manifeston fëmija i caktuar sjellje agresive

Aktiviteti për vlerësim 7

Duhet të mendoni për mënyra të ndryshme me të cilat i vëzhgoni fëmijët. Për shembull, mund t'i vëzhgoni në mënyrë joformale përmes shikimit dhe të menduarit ose përmes metodave më formale të vëzhgimit. Diskutoni me partnerin tuaj në punë se çka janë listat e katalogizimit të kohës dhe listat e katalogizimit të ngjarjeve dhe vëni re rëndësisë së tyre.

Tash mendoni për evidentimin e metodave. Shkruani bashkë me partnerin tuaj të punës nga një raport vijues për njëri-tjetrin ose për dikë tjetër në klasën tuaj. Gjeni fleta kontrolluese të cilat i ka përdorë dikush dhe shihni si duken ato.

Aktiviteti për vlerësim 8

Një pjesë e rëndësishme e vëzhgimit, nëse është e dobishme, është edhe të sigurohet se nuk shpejtojmë me përfundimet. Duhet të jemi objektivë.

Vëzhgojeni dikë në klasën tuaj dhe krahasoni vëzhgimin tuaj me atë të dikujt tjetër. Kjo është mënyrë e mirë që t'i krahasoni pikëpamjet tuaja me ato të dikujt tjetër. A ka dallime në vëzhgimet tuaja? Nëse ka dallime, cilat janë shkaqet e kësaj? Shkruani ato. Duhet të përpiqeni të inkuadroni edhe gjëra të tjera si shikimi i dikujt nga pikëpamja juaj në vend që të jeni objektivë, duke u përpjekur të shikoni jashtë vetes suaj. Një shkak tjetër mund të jetë mosnjohja e personalitetit që vëzhgohet.

Aktiviteti për vlerësim 9

Një pjesë tjetër e rolit të vëzhgimit të fëmijëve është që të dhënat e juaja t'i prezantoni para ndonjë të punësuarit në institucionin tuaj. Diskutoni në grup se kujt do t'ia prezantoni të dhënat dhe shqetësimet tuaja. Mund të zbuloni se ekzistojnë dallime edhe ndërmjet institucioneve. Ju duhet të mbani shënime nga diskutimi juaj, sepse ato do të jenë në dobi të detyrës suaj.

Në grupin tuaj duhet të diskutoni për rëndësinë e besueshmërisë dhe për atë se cilat janë procedurat e këmbimit të informacioneve. Çka nënkupton të menduarit etik? A është etike të vëzhgohen fëmijët që të kuptoni diçka për ata, nëse nuk keni leje nga ata apo nga prindi apo personeli i institucionit? Ju duhet të mbani shënim që të përgatiteni për detyrën tuaj.

Aktiviteti për vlerësim 10

Duhet t'i kompletioni shënimet e këtyre katër aktiviteteve.

Duhet të shkruani se pse është e dobishme të vëzhgohen fëmijët, cilat metoda janë të dobishme, të kihet parasysh nevoja për të qenë objektiv, si dhe të raportohen të dhënat dhe nevojat tuaja për besueshmëri.

1.3. NJOHURI SE SI TË VËZHGOHET ZHVILLIMI I FËMIJËVE НАБЉУДУВАЊЕ НА РАЗВОЈОТ НА ДЕЦАТА

Набљудувањето има мноштво различни улоги во раните години и околината на децата. Како што станувате сè поiskusni во користењето на своите вештини, вие ќе покриете повеќе аспекти од детскиот развој.

Употребете ја оваа контролна листа, или најдете некоја што се користи во вашата установа, за да се осигурете дека ги согледувате и практикувате следните аспекти на развојот, како што ги спроведувате вашите вештини за набљудување.

Vëzhgimi i zhvillimit fizik te fëmijët	Vëzhgimi i zhvillimit social dhe emocional te fëmijët	Vëzhgimi i zhvillimit komunikativ dhe intelektual te fëmijët
<p>Vëzhgoni se si fëmijët:</p> <ul style="list-style-type: none"> • lëvizin • i koordinojnë lëvizjet e tyre • e përdorin hapësirën dhe sendet e mëdha • manipulojnë dhe i përdorin sendet e vogla 	<p>Vëzhgoni:</p> <ul style="list-style-type: none"> • se si fëmijët sillen në situatat e përditshme • se si fëmijët i shprehin emocionet dhe ndjenjat e tyre • se si fëmijët ndërliiden mes vete dhe me të rriturit • se sa kanë fëmijët vetëbesim dhe çka mendojmë për veten e tyre (vetënjohja). 	<p>Vëzhgoni se si fëmijët:</p> <ul style="list-style-type: none"> • luajnë • e përdorin fantazinë e tyre • i marrin rolet e të tjerëve • përqendrohen në aktivitete • i mbajnë mend gjërat • i zgjidhin problemet • i kushtojnë vëmendje asaj që i rrethon • i përdorin shqisat që të marrin informacione të reja.

Lista kontrolluese e aspekteve të zhvillimit që duhet të jenë të vëzhguara

AKTIVITETE PËR VLERËSIM

Aktiviteti për vlerësim 11

Duhet të dëshmoni se jeni të aftë ta vëzhgoni zhvillimin e fëmijës.

Duhet ta vëzhgoni dhe evidentoni zhvillimin fizik, social, emocional, komunikativ dhe intelektual të fëmijëve. Sigurisht se, që të mund ta arrini këtë, ju do të duhet të vëzhgoni disa fëmijë gjatë një periudhë të caktuar kohore.

Aktiviteti për vlerësim 12

Duhet të shpjegoni se si dhe pse keni ndërmarrë disa hapa që të siguron vëzhgim efikas dhe adekuat të fëmijëve. Duhet të jepni përgjigje në këto pyetje:

- Cilat ishin shkaqet e vëzhgimit?
- Pse i zgjodhët metodat që i përdorët?
- Çfarë leje morët?
- Si u përpoqët të jeni sa më objektivë dhe të mos shpejtoni me përfundimet?
- Kujt ia dorëzuat të dhënat tuaja?
- Si e ruajtët besueshmërinë??

Aktiviteti për vlerësim 13

Duhet të mendoni me kujdes për zhvillimin e njërit nga fëmijët që i keni vëzhguar. Duke i përdorë diagramet për zhvillim, që tashmë i keni, duhet të verifikoni se çka mund të pritët nga fëmija i kësaj moshe.

1.4. KUPTIMI I PLANIFIKIMIT TË NEVOJSHËM PËR MBËSHTETJEN E NEVOJAVE DHE ZHVILLIMIN E FËMIJËS

PLANIFIKIMI

Fëmijët kanë nevojë për mbështetje dhe ndihmë që ashtu të inkurajohet zhvillimi i tyre në të gjitha fushat që i kemi shqyrtuar. Roli i të rriturve është që t'i mbështesin fëmijët në zhvillimin e shkathtësive. Kjo mbështetje nuk është e mundur pa një planifikim të kujdesshëm. Planifikimi i mirë është i bazuar në të kuptuarit të detajuar të nevojave të të gjithë fëmijëve të përfshirë.

Gjithë planifikimi dhe përgatitjet e investuara në aktivitet do të jenë huq nëse nuk është menduar për çështjen kryesore: a e kanë arritur fëmijët fazën e kërkuar të zhvillimit dhe a i posedojnë shkathtësitë e nevojshme që të marrin pjesë dhe të kënaqen në aktivitet?

Kuptimi i mirë i zhvillimit të fëmijës dhe vëzhgimi i lojës dhe punës së fëmijëve do t'ju ndihmojnë të krijojnë dituri që do të jetë e nevojshme për ta hartuar përgjigjen e kësaj pyetjeje. Shumica e aktiviteteve janë planifikuar me qëllim që ashtu të zgjerohet niveli i shkathtësive të fëmijëve, por shkathtësitë nuk mund të avancohen ose të zhvillohen nëse fëmija nuk është i përgatitur për hapin e ardhshëm

Cikli i planifikimit

Planifikimi efektiv mund ta krijojë dallim në raport me suksesin e aktivitetit. Ndoshta keni dëgjuar për "ciklin e planifikimit". Cikli i planifikimit është një mjet shumë i dobishëm për punën me fëmijë.

Planifikimi ndodhë në nivele të ndryshme në mjedisin e fëmijës. Ai mund të përgatitet një gjysmëvjetor, një muaj ose një javë me parë. Temat mund të krijohen veçmas për fëmijët më të vegjël, për shembull, për stinët e vitit, për festivalet ose ngjyrat.

Shfrytëzimi i vëzhgimit për mbështetjen e planifikimit

Në kuadër të planit gjithëpërfshirës do të ketë planifikim të një qarku më të vogël të aktiviteteve individuale që ashtu të sigurohet se

Nevojitet më shumë aftësi që të bashkohen pjesët e lojës me harmonizim. Fëmijët së pari duhet të mësohen t'i përdorin lodrat e tilla më të thjeshta Pastaj kalojnë në lodra për harmonizim me pjesë të mëdha, e pastaj në lodra të tilla të ndërlikuara. Nuk është shumë e dobishme që fëmijëve t'u jepet lodër për harmonizim me 20 pjesë, nëse nuk e kanë përvetësuar harmonizimin e lodrës së tillë me gjashtë pjesë!

janë përmbushur nevojat e të gjithë fëmijëve. Kjo do të bazohet në vëzhgimet dhe vlerësimet e fëmijëve me aktivitetet e planifikuara, të cilat janë formuluar që ta mbështetin zhvillimin e tyre deri në fazën e ardhshme

Planifikimi i aktiviteteve

Planifikimi i paorganizuar ndodhë kur një person i rritur u mundëson fëmijëve aktivitet, të cilin do ta shfrytëzojnë në mënyrë të njëjtë. Pasojat mund të jenë shumë më ndryshe nga qëllimi i personit të rritur. Për shembull, aktiviteti me lojën me ujë me enë të ndryshme e me vëllim dhe dendësi të ndryshme mund të rezultojë ashtu që fëmijët t'i hedhin sendet më të rënda dhe t'i përdorin më të voglat, më të lehta, si fjala bie lodrat në formë anijesh.

Aktivitetet e organizuara

Aktiviteti i organizuar është një aktivitet që është planifikuar nga të rriturit, të cilët kanë një rezultat specifik në mësim. Për shembull, aktiviteti me gatim mund të përdoret që ashtu të studiohen përbërësit, të pyesim se pse ndodhin gjëra të ndryshme, kjo si ndihmë e zhvillimit individual, social dhe emocional dhe që ashtu të inkurajohet puna si pjesë e grupit dhe pritja e rendit të secilit veçmas.

Aktivitetet empirike

Aktiviteti empirik e shfrytëzon mjedisin jetësor dhe aktivitetet e pritura dhe jo të priturat, nga të cilat mund të merret mësim, si për shembull ardhjen e qengjave në fushën që është afër

foshnjores; personin e rritur ose fëmijën që shkon në stomatolog.

Aktivitetet tematike

Aktivitetet tematike përdorin aktivitet realist, i cili është i rëndësishëm për përvojën e fëmijës që ashtu t'u mundësojnë atyre të zhvillohen në disa ose në të gjitha fushat e programit mësimor, si për shembull, në vajtjen në parkun lokal ose në shitoren që gjendet në mjedisin e tyre. Plani tematik shpeshherë është i ndarë në disa fusha zhvillimore, që ashtu të sigurohet se janë mundësuar aktivitete përkatëse. Atëherë mund të inkuadrohen edhe aktivitete plotësuese, si fjala bie a ka pata në liqenin e parkut; ndërsa përralla dhe këngët përkatëse mund të përdoren brenda në institucionin edukativ. Puna e rëndësishme kreative që përdor vizatime dhe përvoja mund të planifikohet.

Поддршка на потребите на децата

Mbështetja e nevojave të fëmijës

Nevojat e fëmijëve nënkuptojnë një listë globale gjithëpërfshirës në grupe të ndryshme të moshave, por ato janë specifike për secilin individ. Shikoni këta fëmijë dhe nevojat e tyre.

- 0–3 vjeç: mjedisi i këndshëm dhe i sigurt rutina cilësore për kujdes lidhjet e afërta plot dashuri inkuadrimi dhe qasja e barabartë komunikim mundësia për lojë
- 4–7 vjeç: mjedis i sigurt dhe inkurajues lidhje të afërta dhe të përhershme aktivitete adekuate me moshën, materialet dhe përvojat vlerësimi i rrezikut komunikim reagim konsekuent i sjelljes
- 8–12 vjeç: mjedis i sigurt mundësi për hulumtim dhe përvoja të ndryshme qark i gjerë i metodave të komunikimit leja që të ndërmerren rreziqelavdërimi dhe inkurajimipërgjigje të ndjeshme në çështje serioze mbështetje kur ndërrohen shkollat

13–16 vjeç: mbështetje e mësimimit dhe zhvillimit komunikim pozitiv vlerësimi dhe ndërmarrja e rreziqeve, si dhe ballafaqimi me sfidat lavdërimi dhe inkurajimipranim dhe dashuri

A i vëreni problemet e përbashkët pa marrë parasysh moshën, por edhe nevojën që fëmijës t'i lejohet liri që ta zhvillojë individualitetin e tij?

Është me rëndësi të theksohet se në kuadër të secilës nevojë ka shumë shkarje, varësisht nga secili fëmijë veçmas. Sekretin e mbështetjes së mirë është në përshtatjen me nevojat e secilit fëmijë individualisht.

Ajo informatë mund të merret vetëm përmes vëzhgimit dhe vlerësimimit të hollësishëm.

PJESËMARRJA

Derisa jeni student, ka pak mundësi që të inkuadroheni në mbledhjet formale për planifikim, të cilat mbahen në institucionin tuaj. Megjithatë, ju mund të prezantoni në mbledhje dhe të diskutoni me eprorin për përparimin tuaj, për atë se sa jeni efektiv në aktivitetet tuaja dhe për kohën me fëmijë.

Ju mund të jenë dëshmitar i sjelljes ose prirjeve të një fëmije të caktuar, të cilat nuk janë vërejtur më parë nga personeli tjetër. Po ashtu ju mund të keni ide për aktivitete, për të cilat të tjerët nuk janë kujtuar.

Ju kontribuoni duke dhënë propozime – ndoshta në diskutime me eprorin tuaj ose kuadrin më të moshuar.

Një mënyrë e dobishme që të kuptohet se sa mund të jetë efikas planifikimi, është të theksohet praktika e mirë e institucionit dhe të diskutohet se pse ajo funksionon.

Dallimet kulturore dhe mundësitë e barabarta

Është shumë e rëndësishme që interesat e të gjithë fëmijëve të përmbushen përmes aktivitetit. Për këtë duhet të mendohet me kujdes që të jemi të sigurt se të gjithë fëmijët

A mund të kujtoheni në ndonjë aktivitet për të cilin ju keni qenë të përgatitur, ndërsa fëmija jo? Çka keni bërë në atë rast

mund të inkuadrohen dhe se mund të bëhen përshtatje për secilin fëmijë, i cili është i turpshëm dhe i frikësuar, i cili ka probleme me dëgjimin ose ka koordinim të dobët në lëvizjet e tij, thjesht për secilën nevojë të veçantë që mund ta ketë fëmija. Nëse ka fëmijë me bagazh të ndryshëm kulturor, edhe ata duhet të merren parasysh në mënyrën e njëjtë.

Njoftoni fëmijët hollësisht me kulturat e tjera. Inkuadroni prindërit ose anëtarët e tjerë të bashkësisë që t'ju ndihmojnë dhe mbani shënim për dallimin e të gjitha kulturave tona në mënyrë argëtuese dhe interesante. Mendoni se në çfarë mënyrë mund të promovoni pasqyrë pozitive të kulturave dhe shtresave sociale të ndryshme. Mendoni për librat, për posterët dhe materialet që i përdorni. A ndjehet ndonjë fëmijë i përjashtuar për shkak të atyre gjërave? Për shembull, përralla e cila fokusohet në mjedisin familjar kur të dy prindërit janë në shtëpi, është krejt në rregull, por ajo duhet të baraspeshohet me fotografi të familjeve me një prind.

Nëse i lutni fëmijët të sjellin gjëra për një temë të caktuar, sigurohuni se ajo nuk do të jetë shpenzim i madh për familjen. Bëhuni ndryshëm ndaj fëmijëve kur flisni për festa – për shembull, familjet myslimane ose Dëshmitarët e Jehovait nuk i festojnë Krishtlindjet për arsye të ndryshme.

Vlerësimi i serishëm i aktivitetit që të siguroheni se ai është adekuat për të gjithë fëmijët shpeshherë është vetëm përkujtim për principet themelore të paraqitura në listën e mëposhtme kontrolluese

Zgjidhni dy aktivitete për të cilat nevojiten shkathtësi të ndryshme, me të cilat keni punuar në institucionin tuaj. Bëni një tabelë me moshën e fëmijëve, si dhe me shkathtësitë dhe aktivitetet e nevojshme, por edhe me shënimet për atë se çfarë përgjigje kanë dhënë fëmijët.

- 1 A keni bërë ndryshime për fëmijë të caktuar?
- 2 A konsideroni se duhej të bënit ndryshime?

Vëzhgojeni mirë dhe një kohë të caktuar foshnjoren e organizuar. Në fund pyeteni personin përgjegjës se si ishte organizuar dhe planifikuar koha. Mendoni për aspektet e roleve të moshës ose për nevojën e materialeve që ju kanë bërë përshtypje, ju kanë befasuar, ose tregoni nëse mendoni se ka hapësirë për përmirësim.

Kur planifikoni aktivitete që i zhvillojnë shkathtësitë kreative të fëmijës, mos gaboni që planifikimin tuaj ta bazoni në identitetin tuaj kulturor ose gjinor. Në atë mënyrë nuk do t'i përmbushni të gjitha nevojat tuaja. Shihni shembujt e mëposhtëm:

- Kur gatواني, do të ishte lehtë t'i kufizoni idetë tuaja në ato që janë të njohura për ju, veçmas nëse dëshironi ta ndjeheni mirë në atë aktivitet. Një mënyrë e thjeshtë për zgjerim është të përpiqeni të inkuadroni edhe person të rritur me prejardhje të ndryshme nga ajo që jeni ju.
- Përdorni libra ose programe kompjuterike që janë dygjuhëshe, të cilat do të jenë joshëse për të gjithë fëmijët në çerdhe ose në shkollë.
- Kur krijoni tema duke përdorë sende interesante, shfrytëzoni mundësinë që të fokusoheni në kulturë ose nacionalitet tjetër.
- Zgjidhni një temë, e cila rëndom konsiderohet si mashkullore ose femërore dhe qëllimisht tërhiqeni vëmendjen e të dyja gjinive.

AKTIVITETE PËR PLANIFIKIM

Para se të filloni me planifikimin, sigurohuni se keni dituri të hollësishme për të gjithë fëmijët e grupit tuaj.

- Cilat janë nevojat e secilit fëmijë?
- Si dallohen ato nga nevojat e ndonjë fëmije tjetër?
- Si mund të përshtatet ky aktivitet që t'i përmbushë nevojat e tyre?
- A ka mjaft hapësirë për fëmijët që të lëvizin?
- A u përgjigjet pajisja të gjithë fëmijëve? A jeni furnizuar me brusha të madhësive të ndryshme për ngjyrosje?

- A ka pajisje speciale për fëmijë të caktuar?
- A kanë qasje të gjithë fëmijët në pajisje, që ashtu të promovohet pavarësia?
- A kanë nevojë disa fëmijë për ndihmë praktike, si p.sh. për vendosjen e përparësës, për t'u ulur në tavolinë?
- Pyetni fëmijët a kanë nevojë për ndihmë në vend që të pritni që ata t'ju pyesin.

Si mësojnë fëmijët

Në planifikimin e aktiviteteve të suksesshme bazohen disa principe themelore për atë se si mësojnë fëmijët.

- Fëmijët më së miri mësojnë kur materialet i përgjigjet fazës të cilën ata e kanë arritur në zhvillimin e tyre.
- Vëmendja duhet t'i kushtohet gjithë fëmijës, pra nevojave fizike, morale dhe emocionale, si edhe nevojave intelektuale.
- Fëmijët mësojnë në mënyrë gjithëpërfshirëse; ata nuk bëjnë dalim ndërmjet mësimin të folurit dhe mësimin të numrave.
- Fëmijët mësojnë më mirë kur u lejohej të provojnë dhe të bëjnë gabime.
- Fëmijët kanë nevojë që munda i tyre të pranohet dhe vlerësohet.
- Gjithnjë duhet të filloni me atë që fëmija mund ta bëjë, e jo me atë që fëmija nuk mund ta bëjë.
- Kushtet për mësim duhet të jenë pozitive që kështu ta sigurojnë zhvillimin e kreativitetit dhe fantazisë; fëmijët kanë nevojë për materiale dhe inkurajim.
- Ekziston një kohë e caktuar kur fëmija është i përgatitur të mësojë shkathhtësi të caktuara.
- Është shumë e rëndësishme marrëdhënia e fëmijës me fëmijët e tjerë dhe me të rriturit.
- Duhet t'i njihni nevojat e fëmijës për një moshë dhe fazë të caktuar, të cilën ai e ka arritur. Nuk është shumë e dobishme që ta planifikoni ditën e fëmijës gjashtëmuajsh, ndërsa të mos keni ushqim përkatës ose pelena të nevojshme.
- Mendoni gjithnjë për nevojat individuale të secilit fëmijë dhe mbani mend se ekzistojnë

dallime të mëdha ndërmjet dy fëmijëve të moshës së njëjtë. A e dini se cilat janë dallimet ndërmjet tyre? Mendoni për:

- fazën e zhvillimit
- çka dëshiron dhe çka nuk dëshiron në ushqim
- ndikimin kulturor
- karakterin
- dëshirat e prindërve.

E keni zgjedhur përrallën për Borëbardhën që t'ua lexoni fëmijëve dhe të krijoni aktivitete për të. Ashtu si e lexoni, ju e kuptoni se ajo është e bazuar në gjini dhe pamje. Njerka e ligë është stereotip i madh. Si mund ta përshtatni përrallën me aktivitetet vijuese që kështu të mund t'i hidhni poshtë këto stereotipa?

AKTIVITETE PËR VLERËSIM

Aktiviteti për vlerësim 14

Duke përdorë njërën nga vëzhgimet që tashmë i keni bërë, shkruani se si mund ta përdorni këtë vëzhgim që të planifikoni një aktivitet, i cili do t'ju ndihmojë në zhvillimin e fëmijës. Për shembull, nëse e keni vërejtur se koordinimi sy-dorë i fëmijës nuk është i mirë, ju mund t'i ndihmoni me aktivitet që përfshijnë krijim të vargjeve me rruaza.

Aktiviteti për vlerësim 15

Planifikimi rëndom nuk bëhet vetëm nga ana e një personi. Zakonisht një ekip i vogël i njerëzve mund të mbledhet dhe të diskutojë rreth planeve për aktivitetet e zhvillimit të fëmijës.

Bëni mbledhje planifikimi në grupe të vogla, duke luajtur role, në të cilën do të jepni ide dhe propozime. Diskutoni dhe mbani shënime për këtë aktivitet.

Aktiviteti për vlerësim 16

Këmbeni ide në grupin tuaj dhe bëni lista për atë se si materialet e ndryshme mund ta ndihmojnë lojën e fëmijës dhe si pajisja mund të jetë e dobishme si mbështetje e aktiviteteve të ndryshme.

Aktiviteti për vlerësim 17

Diskutoni në grup të vogël dhe mbani shënime për atë se si mund të mbështeten nevojat e fëmijëve sipas mënyrës me të cilën planifikohen rutinat e kujdesit, siç janë: vajtja në tualet, ushqimi dhe largimi i shprehive nga çka etj.

Aktiviteti për vlerësim 18

Duke i përdorë shënimet tuaja nga katër aktivitetet e tjera, ju mund të mësoni se si të merrni pjesë në planifikimin e mbështetjes së zhvillimit të fëmijës.

Aktiviteti për vlerësim 19

Duke i përdorë vëzhgimet që tashmë i keni përdorë, zgjidhni një prej tyre dhe propozoni plan për mbështetjen e zhvillimit të një fëmije, të cilin e keni vëzhguar.

Aktiviteti për vlerësim 20

Duke e përdorë planin që e keni propozuar në Aktivitetin për vlerësim 19, përshkruani anët e fuqishme dhe të dobëta të këtij plani për plotësimin e zhvillimit të fëmijës së vëzhguar.

Текстот е преземен од BTEC First Children's Care, Learning and Development (Unit 1: Understanding Children's Development)